

UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI MASTER

MËSIMDHËNIE NË GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE



PUNIM DIPLOME

MASTER

Gjilan, 2025

UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI MASTER

MËSIMDHËNIE NË GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE



TEZË MASTERI

Perceptimi i veprave letrare të Ismail Kadaresë

nga nxënësit e klasave VIII-IX

Mentori:

Prof. Dr. Merxhan Avdyli

Kandidatja:

Hatixhe Gashi

Gjilan, 2025

DEKLARATA E AUTORËSISË

Me përgjegjësi të plotë deklaroj se ky punim shkencor është hartuar në mënyrë origjinale nga ana ime, përveç pjesëve të cituara dhe të referuara në mënyrë të rregullt sipas udhëzimeve akademike të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan . Ky punim nuk është paraqitur asnjëherë më parë për vlerësim apo botim në asnjë institucion tjetër arsimor apo shkencor. Çdo informacion i huazuar është trajtuar me integritet akademik dhe në përputhje me standardet e citimit. Ky punim përfaqëson kontributin tim personal në përmbushje të kërkesave të programit të studimeve.

Hatixhe Gashi

E drejta e autorit © 2025. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit

DEDIKIM

Me përlësi dhe mirënjohje të thellë, ia dedikoj këtë punim familjes sime, veçanërisht prindërve të mi të dashur për dashurinë e pakushtëzuar dhe mbështetjen e palëkundur në çdo hap të jetës sime. Faleminderit për besimin dhe forcën që më keni dhënë.

Gjithashtu falënderoj nga zemra shoqërinë dhe të gjithë ata që kanë besuar në rrugëtimin dhe arritjet e mia. Pa ju, kjo ëndërr nuk do të bëhej realitet.

FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE

Ky studim nuk do të kishte marrë formën dhe përfundimin e tij pa ndihmën, përkrahjen dhe inkurajimin e shumë njerëzve, të cilët më qëndruan pranë gjatë gjithë procesit të tij. Ndaj, me përlësi dhe mirënjohje të thellë, dua të shpreh falënderimet e mia më të sinqerta.

Së pari, një falënderim i veçantë dhe mirënjohje e thellë i dedikohet mentorit tim Prof. Dr. Merxhan Avdyli, për besimin që tregoi ndaj meje, për udhëzimet e çmuara, komentet konstruktive dhe sugjerimet e tij të vyera, të cilat ishin udhërrëfyese në ndërtimin dhe finalizimin e këtij punimi.

Mirënjohje dhe falënderime të veçanta shkojnë gjithashtu për të gjithë stafin akademik të Universitetit “Kadri Zeka”, që më kanë pajisur me njohuri të thella dhe më kanë ndihmuar të zhvilloj një qasje profesionale ndaj kërkimit shkencor.

Gjithashtu, falënderoj me shumë respekt dhe mirënjohje mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të mesme të ulëta “Bafti Haxhiu” Viti, “Selami Hallaqi” Gjilan, dhe “Naim Frashëri” Prishtinë për gatishmërinë dhe bashkëpunimin në realizimin e anketave me nxënës, pa të cilat ky studim nuk do të kishte qenë i mundur.

Në fund, një falënderim i përzemërt për familjen time dhe rrethin tim shoqëror për mbështetjen, durimin dhe motivimin e vazhdueshëm që më kanë dhënë në çdo hap të këtij rrugëtimi akademik.

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E AUTORËSISË	3
DEDIKIM	4
FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE	5
LISTA E TABELAVE	8
LISTA E GRAFIKONËVE	8
ABSTRAKT	9
ABSTRACT	10
HYRJE	11
KAPITULLI I.....	14
SHQYRTIMI I LITERATURËS	14
KAPITULLI II.....	17
RËNDËSIA DHE NDIKIMI I LEXIMIT TË VEPRAVE LETRARE NË SHKOLLË	17
2.1. Zhvillimi i të menduarit kritik dhe analitik gjatë leximit	18
2.2. Ndikimi i të lexuarit vepra letrare në përmirësimin e drejtshkrimit.....	19
KAPITULLI III.....	20
KADARE DHE TRAJTIMI I KATËR ROMANEVE TË TIJ.....	20
3.1. Jeta dhe vepra e Ismail Kadaresë	20
3.2. “Kronikë në gur”	21
3.3. “Kështjella”	23
3.4. “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”	24
3.5. “Prilli i thyer”	25
KAPITULLI IV	27
DEFINIMI I PROBLEMIT.....	27
4.1. Qëllimi i hulumtimit.....	27
4.2. Pyetja dhe hipoteza	27
KAPITULLI V	29
METODOLOGJIA E STUDIMIT.....	29
5.1. Modeli i hulumtimit.....	29
5.2. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave	29
5.3. Mostra dhe përzgjedhja e pjesëmarrësve	30
5.4. Grumbullimi i të dhënave dhe respektimi i çështjeve etike	30
5.5. Përpunimi dhe analiza e të dhënave	31

KAPITULLI VI	32
ANALIZA E TË DHËNAVE, REZULTATET DHE DISKUTIMET	32
6.2 Rezultatet e nxjerra nga pyetësorët e zhvilluar me nxënës.....	51
KAPITULLI VII	53
KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET	53
7.1. Konkluzionet.....	53
7.2. Rekomandimet	54
REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE.....	55
SHTOJCA	59

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Të dhënat demografike	32
Tabela 2. A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?.....	35
Tabela 3. Cilat nga titujt e mëposhtëm i ke lexuar?	35
Tabela 4. Sa interesant e ke gjetur veprën që ke lexuar?	37
Tabela 5. Sa të kuptueshme ishin temat dhe mesazhet e veprës së Kadaresë?.....	38
Tabela 6. Ndërlidhja ndërmjet gjinisë dhe pëlqimit për lexim.	39
Tabela 7. Korrelacioni pearson ndërmjet gjinisë dhe pëlqimit për lexim.....	39
Tabela 8. Cilat prej shkollave pëlqejnë më shumë të lexojnë?	40
Tabela 9. Përjetimi emocional dhe kuptimi i veprave të Kadaresë.....	41
Tabela 10. Perceptimi i tematikës dhe karaktereve letrare tek nxënësit.....	42
Tabela 11. Perceptimi i lidhjes midis veprës dhe realitetit aktual.....	44
Tabela 12. Roli i mësimdhënësit në përjetimin dhe kuptimin e veprave	46
Tabela 13. Nevoja për më shumë analiza dhe diskutime për Kadarenë në klasë	48
Tabela 14. Dëshira për të lexuar më shumë nga Kadare ose autorë të ngjashëm	49

LISTA E GRAFIKONËVE

Grafiku 1. Gjinia.....	33
Grafiku 2. Shkolla në të cilën ndjek mësimet.	33
Grafiku 3. Në cilën klasë vijon mësimet?	34
Grafiku 4. A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?.....	34
Grafiku 5. Sa interesante e ke gjetur veprën që ke lexuar?	36
Grafiku 6. Sa të kuptueshme ishin temat dhe mesazhet e veprës/veprave të Kadaresë?	37

ABSTRAKTI

Ky studim trajton perceptimin e nxënësve të klasave VIII dhe IX ndaj veprave letrare të Ismail Kadaresë, me qëllim të kuptimit të mënyrës se si ata i interpretojnë dhe i vlerësojnë këto vepra si pjesë e edukimit të tyre kulturor dhe historik. Hulumtimi u zhvillua me një qasje të kombinuar kuantitative dhe kualitative, duke përdorur pyetësorë me pyetje të hapura dhe të mbyllura, të administruar në tri shkolla në komunat e Prishtinës, Gjilanit dhe Vitisë. Mostra përbëhej nga 130 nxënës të klasave VIII dhe IX, me një përfaqësim të balancuar gjinor dhe gjeografik.

Rezultatet treguan se shumica e nxënësve kanë një perceptim pozitiv për veprat e Kadaresë, ku 46.9% deklaruan se u pëlqen të lexojnë në përgjithësi, dhe mbi 54% i vlerësuan veprat e tij si mjaft ose shumë interesante. Për më tepër, rreth 75% i konsideruan temat dhe mesazhet e veprave si të kuptueshme. Veprat më të lexuara ishin “Kështjella” dhe “Prilli i thyer”, të ndjekura nga “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” dhe “Kronikë në gur”. Megjithatë, u vunë re edhe dallime midis shkollave, duke sugjeruar se ambienti shkollor dhe metodat e mësimdhënies luajnë një rol të rëndësishëm në perceptimin e nxënësve.

Ky studim kontribuon në pasurimin e literaturës vendore mbi letërsinë dhe edukimin, duke ofruar rekomandime për përdorimin e metodave më kreative dhe përfshirëse në trajtimin e veprave të Kadaresë në shkollë. Gjetjet theksojnë nevojën për qasje pedagogjike që mbështesin zhvillimin e mendimit kritik, kuptueshmërisë kulturore, shprehjes emocionale dhe dashurisë për lexim tek nxënësit, duke e bërë procesin mësimor më kuptimplotë dhe më të afërt me përjetimet e tyre.

Fjalët kyçe: *arsimi i mesëm i ulët, Ismail Kadare, letërsia shqipe, metoda pedagogjike, perceptimi i nxënësve.*

ABSTRACT

This study examines the perceptions of eighth- and ninth-grade students toward the literary works of Ismail Kadare, with the aim of understanding how they interpret and value these works as part of their cultural and historical education. The research employed a mixed-methods approach, combining quantitative and qualitative data, through questionnaires with both open-ended and closed-ended questions administered in three schools located in the municipalities of Prishtina, Gjiilan, and Viti. The sample consisted of 130 students from grades VIII and IX, with balanced gender and geographic representation.

The results indicated that the majority of students hold a positive perception of Kadare's works. Specifically, 46.9% reported that they generally enjoy reading, and over 54% rated his works as quite or very interesting. Furthermore, around 75% considered the themes and messages of the works to be understandable. The most frequently read works were *The Castle* and *Broken April*, followed by *The General of the Dead Army* and *Chronicle in Stone*. Nevertheless, differences among schools were observed, suggesting that the school environment and teaching methods play an important role in shaping students' perceptions.

This study contributes to the local literature on education and literary studies by offering recommendations for employing more creative and inclusive methods when teaching Kadare's works in schools. The findings highlight the need for pedagogical approaches that support the development of critical thinking, cultural understanding, emotional expression, and a love of reading among students, making the learning process more meaningful and more closely connected to their lived experiences.

Key words: *Albanian literature, Ismail Kadare, Lower secondary education, Pedagogical methods, Students' perception.*

HYRJE

Letërsia ka luajtur gjithmonë një rol thelbësor në formësimin e mendësisë dhe identitetit të njerëzve, duke shërbyer si pasqyrë e jetës shoqërore, morale dhe kulturore. Ajo përfaqëson një mënyrë të veçantë për të transmetuar përvoja, ndjenja dhe mendime që shpesh nuk mund të shprehen përmes mjeteve të tjera, përmes leximit të veprave letrare, lexuesi zhytet në botën e personazheve, përjeton ndjesitë e tyre dhe reflekton mbi situata që ndonjëherë i tejkalojnë përmasat e përvojës së tij të përditshme (Kanodia & Cornici, 2023). Ky potencial i letërsisë për të zgjuar empati, për të nxitur mendim kritik dhe për të ndërtuar kuptim më të thellë për botën përreth, e bën atë një komponent të pazëvendësueshëm të edukimit. Në këtë kontekst, vepra e Ismail Kadaresë zë një vend të veçantë në fondin kulturor e letrar shqiptar dhe ballkanik. Kadareja, i njohur për ndërthurjen e mjeshtërisë narrative, ka arritur të krijojë një univers letrar që kombinon traditën dhe modernitetin, duke i dhënë letërsisë shqipe një jehonë ndërkombëtare, siç thekson Lamçja (2022), Kadareja nuk solli vetëm risi tematike dhe stilistike, por edhe një përpjekje të vazhdueshme për të ruajtur shpresën për liri dhe për të pasqyruar kompleksitetin e realitetit shqiptar në një mënyrë artistike dhe të fuqishme. Me veprat e tij si *Kronikë në gur*, *Kështjella*, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* dhe *Prilli i thyer*, ai ka ndërtuar një botë që është njëkohësisht e rrënjësuar thellë në historinë dhe kulturën shqiptare, por edhe universale në temat dhe mesazhet që përcjell (Bellos, 2021; Kobayashi, 2022).

Shumë studiues kanë analizuar dimensionet artistike, historike dhe filozofike të veprave të Kadaresë, për shembull, (Ruffles, 2019), vëren se në *Kronikë në gur*, autori, përmes një rrëfimi të ndjeshëm të një fëmije, sjell përjetimet e absurditetit të luftës dhe të përditshmërisë groteske të banorëve të Gjirokastrës. Po ashtu, *Kështjella* (Kadare, 1980), përfaqëson një alegori të qëndresës dhe përplasjeve kulturore në Ballkan, ndërsa *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* është një reflektim i thellë mbi absurditetin e luftës dhe kujtesën historike të një populli të vogël, por krenar (Champseix, 2024). Ndërkaq, *Prilli i thyer* eksploron kontradiktat dhe tragjeditë që lindin nga kodi zakonor i gjakmarrjes dhe ndikimin e tij në ndërgjegjen individuale dhe kolektive (Pali & Mackay, 2021). Pavarësisht kësaj vlere të njohur, hulumtimet mbi perceptimin e nxënësve të arsimit të mesëm të ulët për veprat e Kadaresë mbeten të kufizuara në kontekstin e Kosovës, ku fokusi

arsimor shpesh ka qenë më i theksuar në aspektin kognitiv sesa në përjetimin estetik dhe kritik të tekstit (Soy, Maisarah, & Ly, 2023).

Rëndësia e leximit të veprave letrare në shkollë është e shumëfishtë. (Çitaku & Abdyli, 2024) argumentojnë se letërsia ndihmon në zhvillimin moral dhe shoqëror të nxënësve, duke përcjellë vlera kombëtare dhe universale. Për më tepër, sipas (Stan, 2015), letërsia kontribuon në përgatitjen e fëmijëve për sfidat e një shoqërie komplekse, duke nxitur te ata aftësi reflektuese dhe emocionet që ndihmojnë në ndërtimin e një identiteti të integruar dhe qytetar aktiv. Përveç këtyre, leximi letrar ka ndikim pozitiv edhe në zhvillimin e të menduarit kritik dhe analitik (Phillips, 2023) si dhe në përmirësimin e aftësive gjuhësore dhe drejtshkimore (Karunaratne & Navaratne, 2023). Pikërisht në këtë sfond, ky studim synon të analizojë mënyrën se si nxënësit e klasave VIII dhe IX në tri komuna të Kosovës si: Prishtinë, Gjilan dhe Viti i përjetojnë dhe i interpretojnë veprat e Ismail Kadaresë. Studimi ka për qëllim të eksplorojë përvojat e tyre, të zbulojë sfidat me të cilat përballen në leximin e këtyre teksteve, si dhe të ofrojë rekomandime konkrete për përmirësimin e praktikave pedagogjike në mënyrë që veprat e Kadaresë të bëhen më të qasshme dhe tërheqëse për brezat e rinj. Një tjetër arsye pse ky studim është i rëndësishëm lidhet me mungesën e hulumtimeve empirikë në këtë fushë. Shumë analiza përqendrohen në dimensionet stilistike dhe historike të veprave të Kadaresë, por pak prej tyre përpiqen të kuptojnë efektin e këtyre veprave te lexuesit e rinj në kontekstin shkollor. Duke përdorur një qasje të kombinuar kuantitative dhe kualitative, me pyetësorë me pyetje të hapura dhe të mbyllura, ky studim synon të ofrojë një panoramë sa më të plotë të përvojave të nxënësve dhe të identifikojë praktikën më efektive për t'i afruar ata me tekstin letrar. Përveç qëllimit shkencor, ky hulumtim ka edhe një qëllim praktik: të ndihmojë mësuesit që të zgjedhin metoda më të përshtatshme për të prezantuar dhe analizuar veprat e Kadaresë në klasë, në mënyrë që t'u mundësojnë nxënësve të zhvillojnë aftësi kritike, të kuptojnë mesazhet e thella të teksteve dhe të krijojnë një lidhje emocionale e intelektuale,

Në përfundim, ky studim ka marrë për bazë rëndësinë e pakontestueshme të letërsisë dhe të veprave të Ismail Kadaresë për të kuptuar historinë, kulturën dhe mendësinë shqiptare, dhe synon të kuptojë se si kjo vepër përjetohet nga brezi i ri. Rezultatet e tij mund të ndihmojnë jo vetëm në pasurimin e literaturës mbi ndikimin e

letërsisë të nxënësit, por edhe në përmirësimin e praktikave mësimore që synojnë të forcojnë identitetin kulturor dhe të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik të nxënësve.

KAPITULLI I

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Letërsia ka shërbyer gjithmonë si një pasqyrë e shoqërisë, duke pasqyruar virtytet, dobësitë dhe realitetet ndërmjet tyre. Përtej kësaj funksioni, ajo luan një rol thelbësor në zhvillimin e empatisë dhe mirëkuptimit. Nëpërmjet përjetimit të përvojave të personazheve dhe këndvështrimeve të tyre, lexuesit mësojnë të kuptojnë më mirë ndjenjat dhe sfidat e të tjerëve (Kanodia & Cornici, 2023).

Sipas (Lamçja, 2022) Ismail Kadare është një nga figurat më të rëndësishme të letërsisë shqipe dhe ballkanike moderne, i njohur për ringjalljen e elementeve folklorike në një kohë kur letërsia ishte e varfëruar nga diktatura komuniste ai përmes veprës së tij nuk solli vetëm risi tematike dhe stilistike, por edhe një përpjekje të heshtur për të ruajtur shpresën për liri, duke përdorur motive nga folklori shqiptar, si legjendat dhe përrallat, duke i vendosur në kontekste të reja dhe modern, kombinim i elementeve tradicionale dhe moderne ka bërë Ismail Kadare në veprat e tij i bënë ato të jenë të pasura dhe të shumëdimensionale, duke ofruar një pasqyrë të thellë të shoqërisë dhe historisë shqiptare.

Në një analizë të tij Bellos (2021) thekson se arsyeja kryesore pse duhet të lexojmë Kadarenë është mjeshtëria e tij si tregimtar me aftësinë për të ndërtuar rrëfime që përfshijnë kohë dhe hapësira të ndryshme historike, ndryshe nga Balzaku që u përqendrua te Parisi i shekullit XIX, Kadareja na udhëheq në vende dhe epoka të shumta, nga Egjipti i lashtë e deri te Shqipëria komuniste dhe pas-komuniste, duke krijuar një univers letrar të ndërlidhur me realitetin historik dhe njerëzor me veprat e tij, si *Prilli i thyer*, *Kronikë në gur* apo *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, pasqyrojnë ngjarje të rëndësishme të shek. XIX dhe XX, duke ofruar një mënyrë origjinale për të kuptuar historinë, Kadareja ka një gamë të gjerë krijimtarie – nga poezi dhe ese, deri te mikroromane, novela dhe saga të gjata, që dëshmojnë për thellësinë dhe larminë e veprës së tij, ai ka ndërtuar një botë letrare unike, që reflekton universin real në mënyrë artistike dhe të fuqishme. Tregimet e Kadaresë qëndrojnë më vete, falë ndërthurjes mjeshtërore të mitit, folklorit dhe realitetit modern, ku bota e Kadaresë përfaqëson një Shqipëri alternative të pasur me shtresa, irracionalitet dhe transcendencë që tërheq

lexuesin përmes misterit dhe kompleksitetit të saj, duke e zhytur në një univers imagjinar të paharrueshëm (Kobayashi, 2022).

Romani *Kronikë në gur* zë një vend të veçantë në krijimtarinë e Ismail Kadaresë, pasi përmes një rrëfimi me natyrë autobiografike, autori sjell përvojën e një fëmije në përballje me realitetin përreth, qyteti i Gjirokastrës portretizohet me një ndjeshmëri të veçantë, duke u kthyer në një hapësirë të gjallë dhe simbolike, nëpërmjet syve të fëmijës, Kadare rikthen kujtimet e hershme për të zbuluar burimin e elementeve që më vonë do të përbëjnë thelbin e stilit të tij letrar, të gjitha këto kujtime i mundësojnë autorit të përjetojë dhe të shprehë dimensionin fantastik që e karakterizon gjerësisht veprën e tij (Kadare, *Kronikë në gur*, 1980).

Edhe pse realiteti është i dhunshëm dhe i mbushur me frikë, në romanin *Kronikë në gur*, fëmijëria e narratorit ruan një ndjesi të pafajësisë, duke u përzier me absurditetin e luftës dhe përditshmërinë e banorëve. Kadare përdor me mjeshtëri elemente të mitit, supersticionit dhe realitetit historik për të ndërtuar një narrativë ku qyteti merr një jetë të vetën i vjetër, i lodhur, por rezistent, përmes episodeve tragjikomike dhe ndodhive groteske, autori kritikon në mënyrë të nënkuptuar strukturat shtypëse, përfshirë komunizmin. (Ruffles, 2019).

Në romanin *Kështjella*, Ismail Kadare fokusohet në periudhën mesjetare të historisë shqiptare, duke e eksploruar këtë epokë me një thellësi letrare dhe historike, përmes një narracioni të kujdesshëm, autori krijon një atmosferë të ngjeshur tensioni, duke paraqitur ndjenjat e frikës, guximit dhe qëndresës që ndjejnë protagonistët në kushtet e vështira, elementët e natyrës, si dimri dhe peizazhi i egër përreth kështjellës, shtojnë një dimension simbolik në rrëfimin e tij, duke reflektuar ndjesinë e izolimit dhe të luftës për mbijetesë, Kadare, përmes këtij romani, ofron një vështrim të thellë mbi përplasje të kulturave dhe fatin e një vendi që ndodhet nën rrethim, duke e ndihmuar lexuesin të kuptojë kompleksitetin e historisë shqiptare në atë periudhë (Kadare, 1980).

Gjenerali i ushtrisë së vdekur, njihet si romani i parë modernist që është shkruar në gjysmën e shekullit XX në Shqipëri, kontribuoi për njohjen e autorit dhe letërsisë shqipe në mbarë botën, duke u konsideruar gjithashtu si vepra më e përkthyer në shumë gjuhë.

Në romanin “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” autori shpalos një narrativ të thellë dhe komplekse, e cila jo vetëm që eksploron temën e luftës dhe pasojave të saj, por

gjithashtu pasqyron ndjenjat e humbjes dhe nostalgjisë, duke përshkruar përpjekjet e gjeneralit për të zbuluar të vërtetën mbi fatin e kolonelit, autori hedh dritë mbi marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe italianëve, duke ndihmuar lexuesin të kuptojë më mirë dinamikat e pushtimit dhe ndjenjat e mbijetesës, dhe duke shfaqur një reflektim i thellë mbi identitetin kombëtar, moralitetin dhe çmimin e lirisë, në këtë mënyrë, ky roman jo vetëm që shërben si një dokument historik, por gjithashtu si një kritikë e fuqishme ndaj dhunës dhe pasojave të saj (Kadare, 2007). Sipas Champseix (2024), një nga romanet më të hershme të Ismail Kadaresë që ndikoi në rrjedhën e karrierës së tij ishte *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* (1963), edhe pse në Shqipëri nuk pati ndikim të madh fillimisht, në Francë u prit me entuziazëm në vitin 1970, falë qasjes së veçantë dhe befasuese. romani rrëfen udhëtimin e një oficeri dhe një prifti italian që vijnë në Shqipëri për të mbledhur eshtrat e ushtarëve italianë të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Prilli i thyer shërben si një kritikë e fortë ndaj sistemit të vjetruar e të gjakmarrjes dhe sjell një reflektim mbi pasojat e saj në shoqërinë shqiptare, Kadare përdor një stil të thjeshtë, por të thellë, me një narrativë që shpalos ndjeshmëri dhe emocion, temat kryesore të këtij romani janë; gjakmarrja e cila është një praktikë e thellë në kulturën shqiptare dhe ndikon në jetët e individëve dhe familjeve, kodi zakonor, Kadare eksploron ndikimin e kodit zakonor shqiptar në sjelljet dhe vendimet e personazheve, duke shfaqur tensionin ndërmjet traditës dhe modernitetit por nuk mungojnë as tragjedia, ku elementet tragjike janë të pranishme në të gjithë veprën, duke reflektuar pasojat emocionale dhe psikologjike të konfliktit dhe dhunës (Kadare, 2003). Sipas PALI & MACKAY (2021), romani *Prilli i thyer* (1978), i vendosur në malësitë shqiptare, përdor alegori, mite dhe simbole për të kritikuar indirekt realitetin politik të kohës, duke shmangur drejtpërdrejt censurën. Kritikët kanë theksuar se, edhe pse i vendosur në një të kaluar të largët, romani sfidon idetë e optimizmit socialist, *Prilli i thyer*, megjithëse rrëfen një histori lokale dhe të lidhur me Kanunin, ka fituar vlerësim global për përmbajtjen universale dhe mesazhet njerëzore që përcjellë.

KAPITULLI II

RËNDËSIA DHE NDIKIMI I LEXIMIT TË VEPRAVE LETRARE NË SHKOLLË

Rëndësinë e veprave letrare është e pakontestueshme sepse, ato jo vetëm që ofrojnë aventura interesante, personazhe dhe vende të imagjinuara, por gjithashtu përcjellin mesazhe edukative për nxënësit, këto mesazhe përfshijnë vlera morale dhe shoqërore, ku nxënësit gjithashtu mësojnë të respektojnë vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të kujdesen për mjedisin dhe kafshët. kjo gjithashtu ndihmon në zhvillimin e tyre moral dhe shoqëror (Çitaku & Abdyli, 2024). Letërsia përfaqëson kristalizimin e vlerave që ekzistojnë brenda një shoqërie dhe, në këtë kuadër, ajo ka një funksion të fuqishëm edukativ, ajo përcjell mençurinë popullore në mënyrë të tërthortë, duke pasqyruar dimensionin socio-kulturor të jetës së komunitetit që përshkruan, ku përmes tregimeve, personazheve dhe ngjarjeve, letërsia ndikon në formësimin e paradigmës së individit, në veprime, norma, besime, tradita dhe vlera shoqërore, zhvillimi i letërsisë dhe i shoqërisë ecën paralelisht, me tregimet që pasqyrojnë realitetin përmes roleve dhe ndërveprimeve sociale (Suwadi, 2021).

Sipas studimit të Soy, Maisarah & Ly (2023), perceptimet e nxënësve luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve, mirëpo studimet mbi qëndrimet e tyre ndaj mësimin të letërsisë janë ende të kufizuara, megjithatë tekstet letrare konsiderohen të përshtatshme për mësim, pavarësisht disa sfidave që kërkojnë ndërhyrje nga mësuesit përmes udhëzimit dhe ofrimit të strategjive të përshtatshme të të nxënësve. Shumë sisteme arsimore karakterizohen nga një përqendrim i theksuar në të nxënësve kognitiv, ku përparësia i jepet njohurive, aftësive dhe kompetencave që mund të vlerësohen në mënyrë të objektive, ku si pasojë, aspektet emocionale dhe zhvillimi i brendshëm i fëmijëve shpesh mbeten në hije përballë kërkesës për arritje dhe konkurrencë, andaj në këtë kontekst, letërsia luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin personal të fëmijëve, duke i angazhuar ata emocionalisht përmes rrëfimeve që ndikojnë pozitivisht jo vetëm në formimin e tyre individual, por edhe në procesin e përgjithshëm të të nxënësve (Stan, 2015).

2.1. Zhvillimi i të menduarit kritik dhe analitik gjatë leximit

Sipas Phillips (2023) sot kërkohet nga nxënësit jo vetëm të lexojnë, por edhe të kuptojnë dhe të analizojnë në mënyrë kritike tekstet, çka u mundëson atyre të analizojnë thellësisht tekstet dhe të japin përgjigje ndaj pyetjeve më komplekse që kërkojnë integrim, interpretim, kritikë dhe vlerësim të pavarur të përmbajtjes, përveç kësaj, nxitja e një qëndrimi reflektues ndaj leximit bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, duke i përgatitur nxënësit jo vetëm për sukses akademik, por edhe për sfidat e një shoqërie që kërkon qytetarë të aftë të mendojnë në mënyrë të thelluar dhe të pavarur. Zhvillimi i të menduarit kritik përmes letërsisë mundësohet përmes qasjeve të strukturuar që thellojnë analizën dhe interpretimin letrar, në këto qasje përfshihen: shqyrtimi i motiveve të personazheve, formulimi i pyetjeve kritike gjatë leximit, analiza e simboleve, krahasimi i temave ndërmjet veprave të ndryshme, vlerësimi i përdorimit të mjeteve stilistike, interpretimi i kontekstit historik si dhe diskutimi i dilemave etike, këto strategji nxisin një kuptim më të thelluar dhe një qasje reflektuese ndaj teksteve letrare (Kanodia, 7 Tips for Building Critical Thinking Through Literature, 2025).

Në studimin e autorëve, Gabrielsen, Blikstad-Balas, & Tengberg, (2019), thuhet se, letërsia luan një rol thelbësor në formësimin e mendimit kritik dhe përvetësimin e dijes nga nxënësit, ajo kontribuon në ndërtimin e një identiteti personal dhe një botëkuptimi të veçantë, duke promovuar një qasje gjithëpërfshirëse që merr parasysh kontekstet kulturore e shoqërore të nxënësve, ku përmes përjetimit letrar, nxënësit nxisin reflektimin, analizën dhe kuptimin e thelluar të realitetit, si dhe mësojnë të interpretojnë botën nga këndvështrime të ndryshme. Leximi kritik nënkupton vlerësimin e mënyrës si është ndërtuar një argument brenda tekstit, kjo kërkon që lexuesi të ruajë një distancë të caktuar ndaj tekstit për të reflektuar mbi të, për të zhvilluar këtë aftësi, nxënësit duhet të orientohen të mos lexojnë vetëm për të mbledhur informacione, por për të eksploruar mënyra të ndryshme të të menduarit mbi temën, andaj mësuesit duhet t'i udhëzojnë që, gjatë leximit kritik, të mos fokusohen thjesht në renditjen e fakteve dhe shembujve, por të angazhohen në analizimin, interpretimin dhe ndërtimin e argumenteve, si dhe në formulimin e përfundimeve (Haxhijaha, 2015).

2.2. Ndikimi i të lexuarit vepra letrare në përmirësimin e drejtshkrimit

Studimet kanë treguar se tekstet letrare ndikojnë pozitivisht në përvetësimin e të shkruarit , duke motivuar dhe angazhuar nxënësit më shumë sesa tekstet tradicionale, sepse letërsia ofron një kontekst të natyrshëm për përdorimin e rregullave gjuhësore. pra letërsia ndihmon në zhvillimin e aftësive gjuhësore, krijon mundësi për mendim kritik dhe kreativ, si dhe nxit përgjigje emocionale dhe intelektuale, duke thelluar përjetimin e gjuhës përtej kuptimit të saj të drejtpërdrejtë (Abdallahman, 2021). Një studim gjerman kishte për qëllim të shqyrtonte lidhjet dypalëshe midis të kuptuarit të leximit dhe drejtshkrimit te nxënësit e shkollave të mesme të ulëta ku u analizuan dy mostra nga një studim afatgjatë gjerman, me N = 1227 dhe N = 994 nxënës, të testuar në fillim të klasës së 5-të dhe të 7-të dhe në të dy grupet u konstatua një ndikim i ndërsjellë mes të kuptuarit të leximit dhe drejtshkrimit, me një ndikim më të fortë të të kuptuarit të leximit mbi drejtshkrimin sesa në drejtim të kundërt, këto rezultate jo vetëm që theksojnë rëndësinë e të kuptuarit të leximit për zhvillimin e drejtshkrimit, por gjithashtu pasurojnë literaturën ekzistuese që nënvizon rolin e njohurive drejtshkimore në përmirësimin e kuptimit të leximit (Köller & Retelsdorf, 2014). Ndërsa sipas një studimi në një shkollë private me një mostër prej 30 nxënësish dhe vlerësimeve të mësuesve, u konstatua se nxënësit me shprehje të mira leximi shfaqnin aftësi më të avancuara në shkrim, ndërsa ata me shprehje të dobëta kishin rezultate më të ulëta, këto të dhëna dëshmojnë rëndësinë e leximit për përmirësimin e shkrimit, duke theksuar nevojën që mësuesit të nxisin zhvillimin e shprehjes së leximit që në moshë të vogël (Karunaratne & Navaratne, 2023).

Razaq, Nijabat & Ashfaq (2019) kanë trajtuar rolin e teksteve letrare për përmirësimin e aftësive të shkrimit në nivel fillor, ku kanë ndjekur një qasje cilësore, ku të dhënat janë mbledhur përmes analizës së dokumenteve dhe pyetësorëve me përgjigje të hapura dhe rezultatet treguan ndikimin pozitiv të teksteve letrare në zhvillimin e shkrimit dhe theksuan nevojën për hulumtime.

KAPITULLI III

KADARE DHE TRAJTIMI I KATËR ROMANEVE TË TIJ

3.1. Jeta dhe vepra e Ismail Kadaresë

Ismail Kadare është figura qendrore e kulturës shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe një nga protagonistët kryesorë të modernizimit të letërsisë shqipe. Lindi në Gjirokastrë dhe u arsimua në Universitetin e Tiranës dhe më pas në Institutin "Maksim Gorki" në Moskë. Fillimet e tij letrare ishin në poezi, ndërsa suksesin më të madh e arriti në prozë me romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1963), që shënoi një kthesë të rëndësishme në letërsinë shqiptare. Kadare trajtoi historinë shqiptare si një histori mbijetese dhe identiteti, duke reflektuar përmes veprave si "Prilli i thyer", "Kështjella", "Kronikë në gur", "Kush e solli Doruntinën", etj. Romanet e tij shpesh përdorin simbole si kështjella dhe ura për të trajtuar temat e qëndresës dhe rilindjes. Në vepra si "Nëpunësi i pallatit të ëndrrave", Kadare kritikon totalitarizmin përmes alegorisë. Pas vitit 1990, krijimtaria e tij ruan të njëjtën frymë etnografike dhe thekson identitetin shqiptar. Kadare është përkthyer në mbi 45 gjuhë dhe është nderuar me shumë çmime kombëtare e ndërkombëtare, duke mbetur shkrimtari shqiptar më i njohur në botë. (ASHAK, 2023). Sipas studiuesit dhe shkrimtarit Avdyli (2019), edhe mitologjia në veprat e Kadaresë është një temë po ashtu shumë rëndësishme që shpalos si idetë poetike, ashtu edhe ato filozofike të tij, tema mitologjike shërben gjithmonë për të krahasuar heronjtë, veprimet dhe vendet e lashta me personazhe, ngjarje dhe vende të kohës moderne heronjtë me figura bashkëkohore, veprimet e tyre me zhvillimet aktuale dhe vendet e lashta si vende atdhetare ose armike, Kadare është i njohur jo vetëm për publikun shqiptar, por edhe për atë ndërkombëtar, me veprat e tij të përkthyer në 45 gjuhë të botës.

Prej kohësh janë trajtuar vlerat letrare dhe gjuhësore të Ismail Kadaresë, dhe janë zhvilluar studime të shumta mbi veprat e tij, ku përveç stilit tërheqës dhe përdorimit të pasur të shqipes standarde, Kadare shquhet për kontributin e tij në fushën e leksikut, me theks të veçantë në krijimin e fjalëve të reja, ai respekton rregullat drejtshkrimore dhe gramatikore, por njëkohësisht shpreh individualitetin e tij gjuhësor përmes përdorimit

të pasur stilistik dhe inovativ, studimi shqyrton krijimtarinë e tij gjuhësore, veçanërisht në fushën e fjalëformimit, ku ai synon pastrimin e shqipes nga huazimet dhe pasurimin e saj përmes inputeve leksikore origjinale. fjalët e mbledhura janë ndarë në dy grupe: ato të formuara me parashtesa dhe me prapashtesa, përfshirë edhe forma të përbëra (Celiku, 2016)

3.2. “Kronikë në gur”

Romani “Kronikë në gur” përmban pjesë të shkurtra, disa të titulluara e disa jo, të cilat qëndrojnë të pavarura nga kapitujt kryesorë, artikulli analizon aspektin narrativ të romanit, duke sqaruar pozitën dhe funksionin e rrëfyesve në këto tekste dalluese, ku Kadare, përmes teknikave të tij të rrëfimit, zhvendos vëmendjen e lexuesit tek zhvillimi i ngjarjeve, më shumë sesa tek përfundimi i tyre, në roman paraqiten disa lloje tekstesh: tekste italiane pa titull, fragmente të kronikës, lajme të Plakut Sose, fjalë të personave të panjohur, një skicë përkujtimore dhe rrëfimi bazë nga perspektiva e një fëmije, i ndarë në 18 kapituj, ndonëse të ndërlidhura, këto tekste të veçuara mund të konsiderohen si devijime, pasi edhe nëse hiqen, nuk e cenojnë tërësinë e romanit (Peci, 2019).

Gjuha rrëfimtarëve fëmijë synon të zbulojë elementët gjuhësorë që ndikojnë në nivelin e besueshmërisë së tyre tek lexuesi, kjo vihet re në zgjedhjet leksikore të thjeshta, ndërtimet sintaksore të thjeshtuara, përzierjen e kuptimeve konkrete dhe figurative, si dhe në detajet që zbulojnë sfondin e tyre shoqëror, naiviteti i rrëfimtarëve, i ndërtuar me kujdes përmes këtyre mjeteve stilistike, jo vetëm që shton autenticitet, por forcon edhe lidhjen emocionale dhe interpretimin kritik të lexuesit (Ibishi & Tahiri, 2022). Kadare përcjell mesazhe kritike për realitetin shqiptar në kohën e shkrimeve të romaneve të tij, mitet shërbejnë si mjete për të kritikuar periudhën komuniste dhe tranzicionin post-komunist, pavarësisht kohës historike ku vendosen romanet, për të shmangur censurën e realizmit socialist, Kadare përdor mitet si mbulesë për kritikën e tij, kjo qasje analizohet sidomos në romanet *Kronikë në gur*, përdorimi i mitit vazhdon si mënyrë për të reflektuar mbi shoqërinë shqiptare në ndryshim (Terziu, 2019).

Tema kryesore:

- Lufta dhe fëmijëria në një qytet shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- Ndikimi i pushtimeve të huaja në jetën e përditshme të njerëzve.

- Kujtesa, identiteti dhe humbja e pafajësisë.

Lufta nuk shfaqet përmes betejave heroike, por përmes syve të një fëmije që sheh absurditetet e saj në jetën e qytetit. Historia dhe thashethemet e qytetit ndërthuren, duke krijuar një lloj "kronike" kolektive të mbushur me legjenda dhe realitete. Narracion subjektiv, plot ndjeshmëri fëmijërore, ku realiteti dhe fantazia përzihen. Një ton i lehtë ironik ndaj seriozitetit të të rriturve dhe absurditeteve të jetës gjatë pushtimeve.

Simbolet:

- *Guri* – qëndrueshmëri, kujtesë historike;
- *Fëmija* – pafajësia përballë brutalitetit të botës së të rriturve;
- *Qyteti* – një mikrokozmos i Shqipërisë gjatë kohës së luftës.

Analiza e personazheve në "Kronikë në gur"

- *Narratori (fëmija)*: Është dëshmitar i ngjarjeve, i pafajshëm, kureshtar, ndonjëherë edhe konfuz, përfaqëson këndvështrimin e thjeshtë dhe të sinqertë të jetës, është një personifikim i vetë Kadaresë së vogël.
- *Gjyshja*: Figura e stabilitetit, mençurisë popullore dhe ruajtësja e traditave, një grua që përshtatet dhe mbijeton në çdo situatë, pa iluzione.
- *Iliri* - Miku i narratorit, shok i lojërave dhe aventurave.
- *Gjyshi* – Figura tradicionale, e lidhur me botën osmane, i mbërthyer në të kaluarën, duke lexuar libra turq, përfaqëson një brez të perënduar dhe një Shqipëri që ende s’e ka përqafuar modernitetin.
- *Gjergj Pula* - Personazh grotesk dhe tragjikomik, ai ndryshon emrin në varësi të pushtuesit, duke përqeshur komikisht mënyrën si njerëzit përshtaten për të mbijetuar. Identitet i përkulur dhe i shitur, një satirë ndaj oportunizmit.
- *Suzana* – Dashuria parë e narratorit, paraqet delikatesën e ndjenjave në një botë të shthurur nga dhuna. përmes historisë së saj dhe të vajzës së vrarë për "nder", zbulohet brutaliteti i kodit tradicional të nderit.
- *Banorët e qytetit* – Secili përfaqëson tipare të ndryshme të shoqërisë shqiptare: thashethemet, heroizmin, frikën, servilizmin, qëndresën.
- *Pjesëtarët e ushtrive (italianët, grekët, gjermanët, partizanët)* – Nuk portretizohen si figura heroike, por si pushtues të zakonshëm me mizoritë dhe marrëzitë e tyre, veprimet e tyre theksojnë faktin që pushtimi dhe dhuna janë të njëjta, pavarësisht ideologjisë. (Kadare, 1980).

3.3. “Kështjella”

Sipas studiuesit Mandala (2012), romani rrëfen një rrethim të shekullit XV, strukturë që duket e thjeshtë, ku një ushtri që rrethon një kështjellë, por në të vërtetë eksploron dy procese të pandara si: rrethimin dhe mbrojtjen, që përballen dhe përcaktohen reciprokisht dhe muret e kështjellës shërbejnë si kufi fizik dhe simbolik, duke ndarë dhe bashkuar njëkohësisht dy hapësira: të brendshmen dhe të jashtmen ku, ky tekst ngrihet mbi kundërvënie si “ne” dhe “ata”, “i lirë” dhe “i nënshtruar”, “jeta” dhe “vdekja”. Struktura narrative bazohet në këto polaritete, duke i paraqitur nga dy këndvështrime të ndryshme, të mbrojtësve brenda kështjellës dhe të rrethuesve jashtë saj. Ky dialog mes dy perspektivave krijon një model të ndërlikuar rrëfimi, ku tensioni midis dy hapësirave dhe interpretimeve lejon një analizë të thellë të konfliktit kulturor dhe historik.

Ndërsa nga këndvështrimi i studiuesit Soares (2016), Kadare në veprën “Kështjella” vëzhgon lidhjet intertekstuale, si për shembull motivin e rrethimit (Troja/Kështjella), strukturën e rrëfimit nga këndvështrime të shumta (si “Iliada” që i jep zë edhe trojanëve edhe akejve), dhe temat e nderit, dhunës dhe kujtesës kulturore, ritualet mortore, dhe përdorimi i miteve dhe rapsodëve si instrumente për të ndërtuar një identitet kombëtar shqiptar që përthith trashëgimi klasike dhe ballkanike. Përmes kësaj analize, studiuesi tregon se Kadare ndërton një dialog të thellë kritik mes së kaluarës klasike dhe historisë shqiptare, duke përdorur motivet homerike për të reflektuar mbi luftën, kujtesën dhe të vërtetën historike në Ballkan.

Kadare e vendos figurën e Skënderbeut në vazhden e heronjve të mëdhenj të letërsisë shqiptare si De Rada apo Barleti, por ndryshe nga tradita, e heq nga skena e drejtpërdrejtë e rrethimit, duke ndjekur edhe logjikën historike të strategjisë së tij ushtarake, kjo zgjedhje lejon dy perspektiva narrative: nga njëra anë shqiptari që e lartëson me lutje pothuaj mistike, dhe nga ana tjetër osmanët që e mallkojnë si një armik të frikshëm. Malet luajnë një rol të veçantë simbolik te Kadare, ato nuk janë vetëm mburojë natyrore dhe shenjë e lashtësisë, por shndërrohen në hapësira kërcënuese për pushtuesit, duke ruajtur njëkohësisht funksionin e tyre si simbole të rezistencës dhe mbijetesës. Nga ana tjetër, protagonistin kryesor i romanit është një gjeneral osman i

portretizuar si trim dhe i aftë, por që zbulohet si antihero me mendime të errëta, frikëra dhe hipokrizi. Edhe pse përpiqet të përmbushë urdhrat e sulltanit duke shtrembëruar të vërtetën, ai mbetet një komandant i guximshëm që përballlet me vështirësi të mëdha dhe përfundimisht sakrifikohet, duke e pranuar me dinjitet fatin e tij tragjik (Kadare, 1980).

3.4. “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”

Sipas Rugova (2019), në romanin *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* paraqiten njerëz të një vendi të vogël, krenarë për historinë e tyre, që respektojnë traditat, mikun dhe të vdekurit edhe armiq të. Historia ndjek një gjeneral të huaj dhe një prift që, dekada pas Luftës së Dytë Botërore, vijnë në Shqipëri për të mbledhur eshtrat e ushtarëve të tyre. Udhëtimi i tyre i vështirë përmes një vendi të ashpër zbardh kujtime të dhunshme dhe të zymta të luftës, duke i konfrontuar ata me reliket e një historie të mbetur pezull. Gjenerali, i ftohtë dhe krenar, e sheh veten si dikush që lehtëson vdekjen duke “shpëtuar” të vdekurit nga harresa, por ndërveprimet e tij me realitetin shqiptar i zbulojnë të vërtetën të pakëndshme dhe shtresime të dhunshme të së kaluarës, ku çdo gjurmë nga kockat tek grafitet mbart domethënie të shumta dhe të hidhura.

Temat kryesore

- Qëndresa dhe dinjiteti i popullit shqiptar

Shqiptarët paraqiten si popull i vogël, por krenar dhe i pathyeshëm, që ruan me përkushtim traditat, nderin dhe mikpritjen – edhe ndaj atyre që dikur ishin armiq.

- Absurditeti i luftës dhe pasojat e saj

Misioni i gjeneralit për të mbledhur eshtrat e ushtarëve të vrarë është një udhëtim i zymtë, që nxjerr në pah boshësinë dhe ironinë e fitores së rreme të ushtrive pushtuese.

- Kujtesa historike dhe trauma kolektive

Eshtrat, kujtimet dhe reagimet e banorëve vendës shërbejnë si shënjeshtë të një historie që ende nuk është shëruar dhe që vazhdon të jetojë përmes brezave.

- Identiteti dhe përplasja kulturore

Përballja e të huajve me zakonet dhe mentalitetin shqiptar vë në pah jo vetëm stereotipat e tyre, por edhe thellësinë kulturore të një populli të nëpërkëmbur.

Simbolet:

- Eshtrat dhe thasët e najlonit

Simbole të humbjes, turpit dhe dështimit ushtarak. Ato përfaqësojnë edhe ironinë e një ushtrie që dikur synonte të pushtonte, por tani rikthehet si e thyer.

- Këngët popullore shqiptare

Simbole të kujtesës dhe qëndresës kulturore. Ato shprehin dhimbje kolektive dhe janë mënyra e vetë popullit për të ruajtur historinë dhe për t'ia treguar të tjerëve.

- Relievi dhe moti i zyrtë

Peizazhi shqiptar pasqyron ashpërsinë e së kaluarës, por edhe krenarinë dhe mbylljen e një bote që e refuzon harresën dhe përbuzjen.

Analiza e personazheve

- Gjenerali

Përfaqëson pushtuesin tipik, krenar dhe i bindur në misionin e tij “civilizues”, por gjatë udhëtimit përjeton turp dhe dështim teksa përballet me kujtimet e disfatës. Ai e sheh misionin e mbledhjes së eshtrave si akt nderimi, por kupton peshën tragjike të humbjes.

- Prifti

Është një figurë më e ndërlikuar: përveç rolit fetar, ai është “ekspert” i gjuhës dhe zakoneve shqiptare, i cili mundohet t'i justifikojë mendimet e tij mbi shqiptarët me filozofi të cekët, duke mishëruar një formë tjetër të arrogancës kulturore.

- Plaka Nicë

Simbol i nënave të vuajtura shqiptare dhe urrejtjes së drejtë ndaj agresorit. Me gjestin e saj denoncues, ajo i bën gjyq kolonelit Z dhe gjithë mizorisë pushtuese.

- Koloneli Z

I përmendur shpesh por i padukshëm, i mishëruar vetëm në fund përmes eshtrave të tij. Për vendasit, ai është mishërimi i mizorisë, njeriu që ka shkatërruar familje dhe ka kryer krime monstruoze, duke u bërë simbol i së keqes së pushtimit (Kadare, 2007).

3.5. “Prilli i thyer”

Në analizën *“Dante nella memoria creativa del romanzo ‘Prilli i thyer’ di Ismail Kadare”* nga Blerina Suta, shqyrtohet se si Kadare në romanin *Prilli i thyer* mbështetet në

universin poetik dhe konceptual të Dantes për të ndërtuar një botë narrative që tejkalon kufijtë e realizmit socialist. Kadare përdor imazhet danteske si mjete për të përshkruar jetën e përcaktuar nga Kanuni, duke përçuar ndjesinë e një "udhëtimi ndërmjet dy botëve" – jetës dhe vdekjes – të ngjashme me përshkrimin e Dantes për jetën pas vdekjes. Në roman, personazhi i Gjorgut (gjaksit) shërben si simbol i tragjedisë njerëzore dhe jeton një realitet ku vdekja është një pjesë normale e ekzistencës, ndërsa Besjani dhe Diana, vizitorët nga qyteti, përfaqësojnë një këndvështrim të jashtëm që e sheh këtë botë si të largët dhe të pashpjegueshme. Diana, përmes një udhëtimi shpirtëror të mbushur me simbole si drita, guri dhe humnera, arrin një transformim që e shndërron në një figurë të përngjashme me shpirtrat në purgatorin e Dantes.

Kadare ndërthur imazhet e gurit, mjegullës, udhës së hijes dhe topografisë së malësisë me kodin moral të Kanunit, duke krijuar një hapësirë të mbushur me tension mes jetës dhe vdekjes. Struktura e romanit ndjek një lëvizje rrethore, ku jeta dhe vdekja ndërthuren, dhe ku çdo hap i personazheve duket si një udhëtim midis këtyre dy poleve (Suta, 2021). Artikulli i Vilaça (2024), argumenton se romani *Prilli i thyer* nga Ismail Kadare, nuk është vetëm një rrëfim mbi ligjin zakonor shqiptar, por edhe një mënyrë për të reflektuar mbi fuqinë normuese të ligjit dhe ndikimin e tij përmes simbolikës estetike, ku përmes këtij vështrimi letrar, sugjerohet se ligji ndikon thellësisht në jetën sociale dhe psikologjike, dhe se letërsia ofron një perspektivë të veçantë për të rishqyrtuar rolin e tij në shoqëri, duke sfiduar qasjet tradicionale dhe duke nxjerrë në pah përmasat kulturore e emocionale të së drejtës. Ndërsa sipas (Pali & Mackay, 2021), Ismail Kadare në *Prilli i thyer* përdor imagjinatën historike për të rikrijuar dhe analizuar fenomenin e gjakmarrjes si pjesë të identitetit shqiptar, duke e vendosur tregimin në një peizazh të egër dhe të largët, Kadare nuk e paraqet gjakmarrjen thjesht si traditë lokale, por si një sistem kompleks ligjor, moral dhe simbolik që formëson ndërgjegjen kolektive dhe marrëdhëniet shoqërore, ku romani ndërton një kritikë të hollë ndaj këtij kodi të dhunshëm duke i zbuluar kontradiktat dhe pasojat tragjike, ndërkohë që e vendos këtë fenomen lokal në një kuadër universal të reflektimit mbi ligjin, dhunën dhe drejtësinë.

KAPITULLI IV

DEFINIMI I PROBLEMIT

Veprat e Ismail Kadaresë janë thelbësore për edukimin kulturor dhe letrar të nxënësve, por pak është hulumtuar se si i perceptojnë ato nxënësit e arsimit të mesëm të ulët në Kosovë. Shumë nxënës kanë vështirësi të lidhen me përmbajtjen historike dhe estetike të këtyre veprave, ndërsa mësimdhënia shpesh mbetet monotone dhe pak nxitëse. Këto sfida krijojnë një boshllëk që duhet adresuar përmes analizës së perceptimeve të nxënësve dhe identifikimit të metodave më efektive pedagogjike që i afrojnë më shumë me veprën letrare.

4.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë në mënyrë të detajuar elementet letrare dhe tematike të veprave të përzgjedhura, duke përfshirë strukturën narrative, karakterizimin e personazheve, ambientin kohor dhe hapësinor, dhe mesazhet që ato përcjellin, si dhe të vlerësojë mënyrën se si nxënësit e klasave VIII dhe IX i perceptojnë, kuptojnë dhe interpretojnë këto vepra, duke marrë parasysh përvojat e tyre shkollore e po ashtu të ofroj rekomandime për mësimdhënësit, lidhur me praktikën më të përshtatshme pedagogjike për prezantimin dhe analizën e këtyre veprave në klasë, në mënyrë që të rritet interesi i nxënësve për letërsinë kombëtare dhe të përforcohet lidhja e tyre me tekstin letrar.

4.2. Pyetja dhe hipoteza

Pyetja kryesore:

Si i perceptojnë dhe interpretojnë nxënësit e klasave VIII dhe IX veprat letrare të Ismail Kadaresë?

Hipoteza 1

Nxënësit e klasave VIII dhe IX kanë një perceptim pozitiv dhe të thelluar mbi veprat letrare të Ismail Kadaresë, të cilat i konsiderojnë si të rëndësishme për kuptimin e kulturës dhe historisë shqiptare.

KAPITULLI V

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Ky hulumtim është bazuar në qasje konstruktiviste, sipas Burns, Bally, Burles, Holtslander, & Peacock (2022), nënkupton se realiteti është i ndërtuar nga përvojat dhe perceptimet e njerëzve, duke ndihmuar në thellimin e të kuptuarit tonë mbi sjelljen njerëzore dhe fenomenet shoqërore. Kjo qasje mundësoi një analizë më të hollësishme të mënyrës se si nxënësit perceptojnë dhe interpretojnë veprat letrare të Ismail Kadaresë.

5.1. Modeli i hulumtimit

Siç theksojnë Matthews & Ross (2010), hulumtimet me qasje të kombinuar kuantitative dhe kualitative janë veçanërisht të dobishme kur synohet të kuptohet apo analizohet thellësisht nga perspektiva e pjesëmarrësve, duke u fokusuar në kuptimet dhe përvojat e tyre subjektive. Andaj ky hulumtim ka ndjekur një model kuantitativ dhe kualitativ, sepse ka synuar të hulumtojë përvojat, perceptimet dhe interpretimet e nxënësve në kuadër të trajtimit të veprave letrare të Ismail Kadaresë siç janë: Kronikë në gur, Kështjella, Gjenerali i ushtrisë së vdekur dhe Prilli i thyer.

5.2. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave

Në këtë hulumtim për mbledhjen e të dhënave është përdorur si instrument kryesorë pyetëtori me nxënës. Pyetëtori është përbërë nga pyetje të hapura dhe të mbyllura, ku nxënësit kanë shprehur përvojat e tyre në dy forma.

Siç thekson Petrat (2022) pyetësorët janë veçanërisht të dobishëm për të matur qëndrimet, sjelljet, preferencat dhe perceptimet, kombinimi i pyetjeve të hapura dhe të mbyllura u jep mundësi studiuesve të mbledhin të dhëna si cilësore ashtu edhe sasiore, duke mundësuar rezultate më të plota dhe të balancuara, pyetjet e hapura sipas George (2023) përdoret gjerësisht për të eksploruar në thellësi tema të ndryshme, ku kërkohet të kuptohet më mirë perceptimi, përvoja dhe qëndrimet e respondentëve.

5.3. Mostra dhe përzgjedhja e pjesëmarrësve

Mostra ishte e qëllimshme duke përzgjedhur nxënës nga klasa e VIII dhe IX, sipas Matthews & Ross (2010) & Shaheen, Pradhan, & Ranajee (2019), mostra e qëllimshme është e përshtatshme për hulumtimet cilësore dhe sasiore, sepse ndihmon në sigurimin e përvojave të pasura dhe të thelluara. Numri i respondentëve ka qenë i kufizuar, rreth 130 respondent, duke ndjekur praktikën e studimeve fenomenologjike që kërkojnë përfshirje të mjaftueshme për të arritur analizimin e të dhënave. Përzgjedhja e respondentëve nga komuna e Prishtinës, Gjilanit dhe Vitisë është bërë me qëllim që të sigurohet një përfaqësim i balancuar nga kontekste të ndryshme arsimore në Kosovë.

Prishtina si qendra kryesore arsimore me qasje më të madhe në trajnime dhe politika të zbatuara, duke ofruar perspektivën e një sistemi më të zhvilluar.

Gjilani përfaqëson një zonë me karakteristika të ndërmjetme mes urbanit dhe ruralit, duke mundësuar analizën e sfidave dhe mundësive në një kontekst me qasje më të kufizuar në mbështetje profesionale.

Vitia përfshin perspektivën e shkollave në zona më rurale, ku zbatimi i reformave mund të ketë sfida më të mëdha për shkak të mungesës së burimeve dhe trajnimeve.

Kjo përzgjedhje e qëllimshme e komunave mundësoi krahasimin e përvojave nga nivele të ndryshme të zhvillimit arsimor, duke theksuar dallimet dhe ngjashmëritë në implementimin e politikave dhe në perceptimet e nxënësve. Përfshirja e respondentëve nga këto tre kontekste ndihmoi në krijimin e një panorame më të plotë dhe të balancuar të realitetit arsimor në Kosovë, duke bërë të mundur që të identifikohen praktikën më të mira, si dhe pengesat që duhen adresuar në të ardhmen. Për më tepër, kjo qasje lejoi që hulumtimi të ketë vlefshmëri më të madhe në nivel kombëtar, duke kontribuar në hartimin e politikave më gjithëpërfshirëse dhe më të përshtatura për nevojat specifike të secilit kontekst.

5.4. Grumbullimi i të dhënave dhe respektimi i çështjeve etike

Të dhënat janë mbledhur përmes realizimit të anketave me nxënës duke respektuar parimet etike të kërkimit ashtu siç thekson edhe Bhandari (2024) se etika e

kërkimit është thelbësore për ruajtjen e integritetit shkencor, respektimin e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit, si dhe për promovimin e bashkëpunimit mes shkencës dhe shoqërisë, këto parime sigurojnë që pjesëmarrësit në studime të jenë të informuar, të mund të marrin pjesë me vullnet dhe në kushte të sigurta.

Nga pikëpamja etike, çdo nxënës është njoftuar në detaje për qëllimin e studimit dhe të dhënat janë trajtuar me konfidencialitet të plotë. Në studimet e kombinuara, ruajtja e anonimitetit dhe konfidencialitetit të pjesëmarrësve është e domosdoshme. Sipas Mirza, Bellalem & Mirza (2023), studiuesit duhet të mbrojnë identitetin e pjesëmarrësve duke përdorur pseudonime, ruajtur të dhënat në mënyrë të sigurt dhe kufizuar qasjen në to vetëm për qëllime analize, duke siguruar gjithashtu pëlqimin e informuar dhe respektuar standardet etike akademike për konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave të grumbulluara.

5.5. Përpunimi dhe analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave në këtë hulumtim është bërë përmes programit SPSS dhe përmes analizës tematike, sipas Naeem, Howell & Ranfagni (2023) analiza tematike është një metodë për analizimin e të dhënave cilësore, që përfshin identifikimin dhe raportimin e modeleve në një grup të dhënash, të cilat interpretohen për të kuptuar thelbin e tyre. Kjo metodë ishte shumë e përshtatshme dhe shumë fleksibile, duke ofruar një qasje të mirë për të zbuluar pikëpamjet, opinionet, njohuritë ose përvojën e individëve në lidhje me një temë të caktuar. Përdorimi i analizës tematike për analizimin e të dhënave përfshiu një proces prej 6 hapash:

- 1) familjarizimi me të dhënat;
- 2) kodimi i tyre;
- 3) krijimi i temave;
- 4) shqyrtimi i temave;
- 5) përcaktimi dhe emërtimi i temave;
- 6) raportimi i gjetjeve (Jones, 2022)

KAPITULLI VI

ANALIZA E TË DHËNAVE, REZULTATET DHE DISKUTIMET


Tabela 1. Të dhënat demografike

		Numri i rasteve	Përqindje	Përqindje e vlefshme	Përqindje kumulative
Gjinia	Femër	70	53.8	53.8	53.8
	Mashkull	60	46.2	46.2	100.0
	Total	130	100.0	100.0	
Shkolla në të cilën ndjek mësimet?	SHFMU “Bafti Haxhiu”, Viti	48	36.9	36.9	36.9
	SHFMU “Naim Frashëri”, Prishtinë	47	36.2	36.2	73.1
	SHFMU “Selami Hallaçi”, Gjilan	35	26.9	26.9	100.0
	Total	130	100.0	100.0	
Në cilën klasë vijon mësimet?	Klasa VIII	55	42.3	42.3	42.3
	Klasa IX	75	57.7	57.7	100.0
	Total	130	100.0	100.0	

Në këtë studim morën pjesë gjithsej 130 nxënës të arsimit të mesëm të ulët, me një shpërndarje të balancuar gjinore: 53.8% femra (n=70) dhe 46.2% meshkuj (n=60). Pjesëmarrësit vijnë nga tre shkolla të ndryshme: SHFMU “Bafti Haxhiu” në Viti (36.9%), SHFMU “Naim Frashëri” në Prishtinë (36.2%) dhe SHFMU “Selami Hallaçi” në Gjilan (26.9%). Për nga klasa, 42.3% e nxënësve ndjekin klasën e 8-të (n=55), ndërsa shumica relative, 57.7% (n=75), vijojnë klasën e 9-të. Kjo shpërndarje demografike siguron një përfaqësim të mirë të gjinive dhe niveleve të klasës, si dhe një përfshirje gjeografike të tre komunave, duke mundësuar një pasqyrë më të gjerë mbi perceptimet e nxënësve për veprat letrare të Ismail Kadaresë në kontekstin e arsimit të mesëm të ulët në Kosovë.

Gjinia?


130 responses



Grafiku 1.Gjinia.

Shkolla në të cilën ndjekë mësimet?


130 responses



Grafiku 2. Shkolla në të cilën ndjek mësimet.

Në cilën klasë vijon mësimet?


130 responses



Grafiku 3. Në cilën klasë vijon mësimet?

A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?

130 responses



Grafiku 4. A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?

Tabela 2. A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?

A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?					
		Numri i rasteve	Përqindja	Përqindje e vlefshme	Përqindje kumulative
Valid	Jo	20	15.4	15.4	15.4
	Nganjëherë	49	37.7	37.7	53.1
	Po	61	46.9	46.9	100.0
	Total	130	100.0	100.0	

Në pyetjen e parë **“A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?”**, me opsionin **"Po"** janë përgjigjur gjithsej **61 nxënës**, që përbëjnë **46.9%** të të anketuarve. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e nxënësve të klasave VIII dhe IX kanë një prirje pozitive ndaj leximit në përgjithësi.

Me opsionin **"Nganjëherë"** janë përgjigjur **49 nxënës**, ose **37.7%**, çka tregon një qasje neutrale apo të varur nga tematika apo mënyra e prezantimit të tekstit.

Ndërsa me opsionin **"Jo"** janë përgjigjur **20 nxënës**, që përfaqësojnë **15.4%** të të anketuarve.

Nga të dhënat kuptojmë se **84.6%** e nxënësve (së bashku ata që kanë zgjedhur **“Po”** dhe **“Nganjëherë”**) kanë të paktën një qasje pozitive ose të hapur ndaj leximit, gjë që është shumë e rëndësishme për qëllimin e këtij studimi, pasi sugjeron se **perceptimi i veprave të Ismail Kadaresë** nga kjo grupmoshë ka gjasa të jetë i formësuar nga një përvojë e përgjithshme pozitive me tekstin letrar.

Tabela 3. Cilat nga titujt e mëposhtëm i ke lexuar?

Cilat nga titujt e mëposhtëm i ke lexuar?		Përgjigjet		Përqindje e rasteve
		N	Përqindje	
	Prilli i thyer	30	20.3%	29.7%
	Kronikë në gur	23	15.5%	22.8%
	Gjenerali i ushtrisë së vdekur	27	18.2%	26.7%
	Kështjella	68	45.9%	67.3%
Total		148	100.0%	146.5%

Në pyetjen e dytë **“Cilat nga titujt e mëposhtëm i ke lexuar?”**, nxënësve u është kërkuar të shënojnë cilat nga veprat e Ismail Kadaresë i kanë lexuar. Pasi ishin të lirë të zgjidhnin më shumë se një titull, numri total i përgjigjeve është më i madh se numri i nxënësve (148 përgjigje gjithsej nga 130 nxënës).


Me opsionin **"Kështjella"** janë përgjigjur gjithsej **68 nxënës**, që përbëjnë **45.9%** të totalit të përgjigjeve dhe **67.3%** të të anketuarve. Kjo tregon se kjo vepër është më e lexuara dhe ndoshta më e pranishmja në planprogramin mësimor të kësaj grupmoshe.

Me opsionin **"Prilli i thyer"** janë përgjigjur **30 nxënës**, përkatësisht **20.3%** e përgjigjeve dhe **29.7%** e rasteve, çka tregon një interes mesatar për këtë vepër.

Me opsionin **"Gjenerali i ushtrisë së vdekur"** janë përgjigjur **27 nxënës** (18.2% e përgjigjeve dhe 26.7% e rasteve), që gjithashtu përbën një përqindje relativisht të lartë.

Me opsionin **"Kronikë në gur"** janë përgjigjur **23 nxënës**, që përfaqësojnë **15.5%** të përgjigjeve dhe **22.8%** të rasteve.

Nga të dhënat del se **vepra më e lexuar është “Kështjella”**, ndërsa tre veprat e tjera kanë një përfaqësim të ngjashëm por më të ulët. Kjo mund të lidhet me përfshirjen më të gjerë të “Kështjellës” në tekstet shkollore ose me përmbajtjen që i përshtatet më shumë nivelit të nxënësve. Kjo gjithashtu mbështet **hipotezën** se nxënësit kanë një kontakt real dhe të drejtpërdrejtë me veprat e Kadaresë dhe se perceptimi i tyre ndërtohet mbi përvojën e leximit konkret.



Grafiku 5. Sa interesante e ke gjetur veprën që ke lexuar?

Tabela 4. Sa interesante e ke gjetur veprën që ke lexuar?


Sa interesante/e ke gjetur veprën (veprat) që ke lexuar? (Vlerëso në një shkallë nga 1 në 5, ku 1 = aspak interesante dhe 5 = shumë interesante)					
		Numri i rasteve	Përqindja	Përqindje e vlefshme	Përqindje kumulative
E vlefshme	1	19	14.6	14.6	14.6
	2	13	10.0	10.0	24.6
	3	27	20.8	20.8	45.4
	4	45	34.6	34.6	80.0
	5	26	20.0	20.0	100.0
	Total	130	100.0	100.0	

Në pyetjen e tretë: “Sa interesante/e ke gjetur veprën (veprat) që ke lexuar? (Vlerëso në një shkallë nga 1 në 5, ku 1 = aspak interesante dhe 5 = shumë interesante)”, me **opsionin “1 – aspak interesante”** janë përgjigjur gjithsej **19 nxënës**, që përbën **14.6%** të të anketuarve. Me **opsionin “2”** janë përgjigjur **13 nxënës** apo **10.0%**. Me **opsionin “3”** janë përgjigjur **27 nxënës**, që përbënin **20.8%** të përgjigjeve. Me **opsionin “4”** janë përgjigjur **45 nxënës** apo **34.6%**, ndërsa me **opsionin “5 – shumë interesante”** janë përgjigjur **26 nxënës**, që përbëjnë **20.0%** të gjithsej të anketuarve.

Këto të dhëna tregojnë se shumica e nxënësve i kanë vlerësuar veprat e Kadaresë si interesante (opsionet 4 dhe 5 së bashku përbëjnë **54.6%** të përgjigjeve), çka sugjeron një pranim pozitiv të këtyre veprave në mesin e nxënësve të klasave VIII-IX. Një përqindje më e vogël ka shprehur mosinteresim (opsionet 1 dhe 2 gjithsej **24.6%**), ndërsa **20.8%** kanë pasur një qëndrim neutral.

Sa të kuptueshme ishin temat dhe mesazhet e veprës/veprave të Kadaresë?

130 responses



Grafiku 6. Sa të kuptueshme ishin temat dhe mesazhet e veprës/veprave të Kadaresë?

Tabela 5. Sa të kuptueshme ishin temat dhe mesazhet e veprës së Kadaresë?

Sa të kuptueshme ishin temat dhe mesazhet e veprës/veprave të Kadaresë?					
		Numri i rasteve	Përqindja	Përqindje e vlefshme	Përqindje kumulative
E vlefshme	Mesatarisht të kuptueshme	33	25.4	25.4	25.4
	Mjaft të kuptueshme	37	28.5	28.5	53.8
	Shumë të kuptueshme	28	21.5	21.5	75.4
	Shumë të vështira	15	11.5	11.5	86.9
	Të vështira për t'u kuptuar	17	13.1	13.1	100.0
	Total	130	100.0	100.0	

Në pyetjen e katërt: “Sa të kuptueshme ishin temat dhe mesazhet e veprës/veprave të Kadaresë?”, me **opcionin “Mesatarisht të kuptueshme”** janë përgjigjur gjithsej **33 nxënës**, që përbëjnë **25.4%** të të anketuarve. Me **opcionin “Mjaft të kuptueshme”** janë përgjigjur **37 nxënës** apo **28.5%**. Me **opcionin “Shumë të kuptueshme”** janë përgjigjur **28 nxënës**, që përbëjnë **21.5%** të totalit. Me **opcionin “Shumë të vështira”** janë përgjigjur **15 nxënës** (11.5%), ndërsa me **opcionin “Të vështira për t'u kuptuar”** janë përgjigjur **17 nxënës** apo **13.1%**.

Nga këto të dhëna, mund të konkludohet se shumica e nxënësve (rreth **75.4%**) e kanë perceptuar përmbajtjen e veprave si të kuptueshme në një shkallë mesatare deri shumë të kuptueshme. Megjithatë, një përqindje jo e vogël (rreth **24.6%**) ka hasur vështirësi në kuptimin e temave dhe mesazheve. Kjo tregon për nevojën që në procesin mësimor të përdoren metoda më efektive të analizës letrare, në mënyrë që përmbajtja e veprave të Kadaresë të bëhet më e qasshme për nxënësit e këtyre moshave.

Tabela 6. Ndërlidhja ndërmjet gjinisë dhe pëlqimit për lexim.

Korrelacioni ndërmjet gjinisë dhe pëlqimit për lexim					
		A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?			Total
		Po	Jo	Nganjëherë	
Gjini a	Mashkull	21	15	24	60
	Femër	40	5	25	70
Total		61	20	49	130

Në tabelën e ndërlidhjes midis gjinisë dhe preferencës për leximin në përgjithësi, shihet se nga 60 nxënës meshkuj, 21 prej tyre thanë se u pëlqen të lexojnë, 15 nuk u pëlqen dhe 24 lexojnë vetëm nganjëherë. Ndërsa nga 70 nxënëse femra, 40 u pëlqen të lexojnë, vetëm 5 nuk u pëlqen dhe 25 lexojnë nganjëherë. Kjo tregon një tendencë më të lartë pozitive për lexim tek femrat në krahasim me meshkuj.

Tabela 7. Korrelacioni pearson ndërmjet gjinisë dhe pëlqimit për lexim

Korrelacioni ndërmjet gjinisë dhe pëlqimit për lexim			
		Gjinia	A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?
Gjinia	Pearson Correlation	1	-.144
	Sig. (2-tailed)		.102
	N	130	130
A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?	Pearson Correlation	-.144	1
	Sig. (2-tailed)	.102	
	N	130	130

Po ashtu, për të vlerësuar nëse ekziston një lidhje mes gjinisë dhe përgjigjeve për pyetjen “A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?”, u përdor analiza e korrelacionit Pearson. Rezultatet treguan një lidhje negative të dobët mes gjinisë dhe preferencës për lexim ($r = -0.144$), që do të thotë se femrat pak më shumë preferojnë të lexojnë se sa meshkujt. Megjithatë, kjo lidhje nuk është statistikisht e rëndësishme ($p = 0.102$), duke sugjeruar

që nuk ka një marrëdhënie të fortë ose të qartë midis gjinisë dhe interesit për lexim në këtë mostër.

Tabela 8. Cilat prej shkollave pëlqejnë më shumë të lexojnë?

<i>Shkolla në të cilën ndjek mësimet? & A të pëlqen të lexosh në përgjithësi? Krahاسimi</i>					
		A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?			Total
		Po	Jo	Nganjëherë	
Shkolla në të cilën ndjek mësimet?	SHFMU “Naim Frashëri”, Prishtinë	28	8	11	47
	SHFMU “Selami Hallaçi”, Gjilan	16	5	14	35
	SHFMU “Bafti Haxhiu”, Viti	17	11	20	48
Total		61	24	45	130

Në tabelën e ndërlidhjes midis shkollës ku ndjekin mësimet nxënësit dhe përgjigjeve për pyetjen **“A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?”**, vërehet se nga **47 nxënësit e SHFMU “Naim Frashëri”, Prishtinë**, 28 shprehen se u pëlqen të lexojnë, 8 thonë se nuk u pëlqen, ndërsa 11 lexojnë vetëm ndonjëherë. Në **SHFMU “Selami Hallaçi”, Gjilan**, nga 35 nxënës, 16 deklarojnë se u pëlqen të lexojnë, 5 jo, dhe 14 lexojnë ndonjëherë. Në **SHFMU “Bafti Haxhiu”, Viti**, nga 48 nxënës, 17 shprehen pozitivisht për leximin, 11 negativisht, ndërsa 20 e bëjnë këtë ndonjëherë.

Këto rezultate tregojnë se përqindja më e lartë e nxënësve që e pëlqejnë leximin është në **SHFMU “Naim Frashëri”, Prishtinë**, krahasuar me dy shkollat e tjera. Kjo mund të shpjegohet me faktin që si një shkollë e vendosur në kryeqytet, nxënësit kanë më shumë mundësi dhe ekspozim ndaj burimeve të leximit, aktiviteteve kulturore dhe një mjedisi që e inkurajon më shumë këtë praktikë. Ndërkohë, në shkollat e Gjilanit dhe të Vitisë, përqindja e nxënësve që lexojnë është më e ulët dhe një pjesë e madhe e tyre deklarojnë se lexojnë vetëm herë pas here. Ky dallim mund të lidhet me sfida të ndryshme që hasen në këto mjedise, si qasje më e kufizuar në libra, mungesa e aktiviteteve motivuese për lexim, apo prioritete të tjera që i largojnë nxënësit nga leximi.

Megjithatë, në të gjitha shkollat vërehet një grup i konsiderueshëm i nxënësve që lexojnë ndonjëherë, çka sugjeron se ekziston një potencial i madh për të përmirësuar

motivimin për lexim në të gjithë kontekstet. Kjo nënvizon rëndësinë e politikave arsimore dhe të iniciativave shkollore që synojnë të ofrojnë më shumë mundësi për lexim, të zhvillojnë biblioteka më të pasura dhe të organizojnë aktivitete që e bëjnë leximin më tërheqës për të gjithë nxënësit, pavarësisht mjedisit ku jetojnë.

Tabela 9. Përjetimi emocional dhe kuptimi i veprave të Kadaresë

Temat dhe kodet e dala nga përgjigjet e nxënësve	
Përjetimi emocional dhe kuptimi i veprave të Kadaresë	➤ Përjetim emocional dhe imagjinatë ➤ Krenari kombëtare dhe patriotizëm ➤ Mesazhe të kuptueshme dhe të thella ➤ Histori dhe realitet shqiptar ➤ Shtytje për të menduar dhe imagjinuar ➤ Vështirësi në kuptim për disa

"Kur lexova 'Kështjella' u ndjeva krenar për popullin shqiptar që nuk ia dorëzonte kështjellën osmanëve." (Nx18, Prishtinë)

Nx18 nga Prishtina, tregon një ndërthurje të fortë empatike dhe imagjinate, ku lexuesi identifikohet me personazhet dhe situatat. Ky lloj përjetimi pasqyron atë që teoricienët e letërsisë e quajnë transaksion estetik një proces ku kuptimi nuk gjendet vetëm në tekst, por krijohet nga bashkëveprimi midis lexuesit dhe tekstit.

"Veprat e Kadaresë ishin shumë të kuptueshme dhe na jepnin disa mesazhe mbresëlënëse." (Nx8, Prishtinë)

Ky pohim pasqyron perceptimin e disa nxënësve se Kadare arrin të transmetojë tema morale dhe filozofike në mënyrë të qartë, duke bërë mesazhin të arritshëm për brezin e ri. Kjo tregon aftësinë e autorit për të ndërtuar një diskurs të kuptueshëm që i flet drejtpërdrejt lexuesit, duke e bërë atë të reflektojë mbi pyetje të rëndësishme si ndërgjegjja morale, përgjegjësia dhe historia.

"Më shtini në një botë shumë interesante e cila më bëri të ndihem shumë krenare." (Nx11, Gjilan)

Ky lloj përjetimi tregon se veprat e Kadaresë nuk janë vetëm tekste për t'u lexuar, por edhe hapësira për të ndërtuar identitet dhe vetëdije historike, duke ofruar modele të qëndrueshmërisë dhe guximit.

"Më shtyu të mendoja më thellë për kuptimin e rreshtave të shkruar dhe ndihesha i suksesshëm kur i lexoja." (Nx12, Gjilan)

Ky citim është veçanërisht domethënës për mënyrën se si leximi mund të nxisë shkathtësi metakognitive te nxënësit. Ai tregon jo vetëm angazhim emocional, por edhe kapërcim nga leximi sipërfaqësor tek interpretimi kritik, ku nxënësi kërkon kuptim më të thellë, ndërlidh tema dhe analizon mesazhe.

"Mua ma jep një ndjenjë sikur ndodhia po më ndodhin mua." (Nx1, Viti)

"Gjatë leximit të veprave jam ndjerë sikur t'i përjetoja vet ato veprime." (Nx14, Viti)

Kjo aftësi e veprës për të "zhytur" lexuesin në botën e saj dëshmon për fuqinë narrative dhe realiste të Kadaresë, që arrin të gjenerojë përjetim të drejtpërdrejtë emocional ndërmjet lexuesit dhe vetë veprës së tij.

Gjatë analizës së përgjigjeve për përjetimin e leximit, nxënësit shfaqin emocione të forta dhe lidhje personale me tekstin. Ata e përjetojnë veprën si një udhëtim imagjinar që i vendos në ngjarjet historike, duke përjetuar krenari për identitetin kombëtar. Shumë e vlerësojnë gjuhën e qartë dhe mesazhet morale që i konsiderojnë aktuale. Mesazhet morale dhe mënyra e qartë e shkrimit i bëjnë veprat të aksesueshme për shumë nxënës, duke i bërë ato mjete për edukim moral dhe zhvillim kritik. Në të njëjtën kohë, disa nxënës hasin vështirësi për shkak të tematikave komplekse ose kontekstit historik të largët, duke theksuar rolin qendror të mësimdhënësit për të ndihmuar në dekonstruktimin e kuptimit dhe për të bërë tekstin të jetueshëm dhe kuptimplotë. Në përgjithësi, analiza tematike e përgjigjeve tregon se veprat e Kadaresë kanë potencial të fuqishëm edukativ dhe formues, por kërkojnë një qasje pedagogjike të ndjeshme dhe të ndërgjegjshme që mbështet përjetimin emocional, nxit imagjinatën dhe ndihmon në ndërtimin e kuptimeve të thella dhe të shumëfishta.

Tabela 10. Perceptimi i tematikës dhe karaktereve letrare tek nxënësit

Temat dhe kodet e dala nga përgjigjet e nxënësve	
Perceptimi i tematikës dhe karaktereve letrare tek nxënësit	➤ Heroizëm dhe guxim ➤ Besë, hakmarrje dhe kodi moral shqiptar ➤ Tematika historike dhe kombëtare ➤ Përshkrim i thellë dhe emocional ➤ Kuptimi i vlerave tradicionale ➤ Pëlqim për stilin dhe përshkrimet

"Kështjella më ka lënë përshtypje mënyra e jetesës së shqiptarëve." (Nx29, Prishtinë)

Ky perceptim tregon se veprat e Kadaresë funksionojnë si tekste kulturore që transmetojnë modele të qëndrueshmërisë dhe rezistencës, duke u bërë burim identiteti dhe frymëzimi për brezat e rinj.

"Më pëlqeu mençuria e fjalëve të autorit." (Nx31, Prishtinë)

Ky citim tregon ndërgjegjësim për dimensionin estetik dhe filozofik të tekstit, nxënësit nuk e reduktojnë përjetimin vetëm në ngjarje apo histori, por dallojnë aftësinë e autorit për të shprehur ide të thella, reflektime morale dhe nuanca emocionale.

"Skënderbeu dhe ushtarët e tij sepse ujin ia kanë helmuar." (Nx15, Viti)

Kjo përgjigje tregon sensibilitet për sakrificën dhe dinakërinë në mbrojtjen e atdheut, duke e parë Skënderbeun jo vetëm si figurë historike, por si strateg dhe mbrojtës të popullit.

"Tema kur Gjorgu merr hak e po ashtu Gjorgu më ka pëlqyer si personazh ishte njeri i mire, sepse ka qenë personazhi kryesor i romanit dhe ka pasur afat të jetonte deri në gjysmën e prillit" (Nx24, Gjilan)

Gjorgu si figurë mishëron kodin moral të Kanunit, ku besa, nderi dhe hakmarrja janë parime thelbësore. Nxënësit që zgjedhin këtë personazh tregojnë se ata janë të ndjeshëm ndaj dilemas morale që Kadare paraqet: a është e drejtë të mbrosh nderin përmes gjakmarrjes?.. Kjo e bën tekstin didaktik dhe problematizues, duke u ofruar nxënësve mundësinë për të diskutuar mbi vlerat tradicionale dhe sfidat e tyre në kohët modern.

Nxënësit përzgjedhën tema dhe personazhe që mishërojnë vlerat e guximit dhe besës. Analiza tematike e përgjigjeve të nxënësve zbulon se perceptimi i temave dhe personazheve në veprat e Kadaresë është i pasur dhe shumëdimensional. Nxënësit jo vetëm që identifikojnë ngjarjet historike dhe kontekstin kombëtar, por edhe hyjnë në analizë të vlerave morale dhe etike që personazhet përçojnë.

Heroizmi dhe guximi shfaqen si vlera qendrore, duke shërbyer si modele identiteti kombëtar, besa, hakmarrja dhe kodi moral shqiptar, veçanërisht në *Prilli i thyer*, krijojnë hapësirë për debat etik dhe kulturor, duke i bërë nxënësit të reflektojnë mbi trashëgiminë e tyre dhe sfidat e modernitetit.

Përshkrimi i detajuar dhe mençuria e gjuhës letrare e Kadaresë nxit një vlerësim estetik dhe intelektual që shkon përtej ngjarjes, duke forcuar aftësitë analitike dhe interpretative të nxënësve.

Në këtë mënyrë, veprat e Kadaresë mund të shërbejnë si mjet i fuqishëm edukativ, duke integruar edukimin historik, moral, kulturor dhe estetik. Për mësimdhënësit, kjo është një mundësi për të zhvilluar pedagogji të pasura, që nxisin diskutim kritik, analizë të thellë dhe reflektim personal, duke ndihmuar në formimin e lexuesve të angazhuar dhe qytetarëve të ndërgjegjshëm.

Tabela 11. Perceptimi i lidhjes midis veprës dhe realitetit aktual

Temat dhe kodet e dalura nga përgjigjet e nxënësve	
Perceptimi i lidhjes midis veprës dhe realitetit aktual	➤ Lidhje të pjesshme me realitetin e sotëm ➤ Mesazhe universale dhe morale ➤ Fokus te historia dhe e kaluara ➤ Vlera të përhershme njerëzore ➤ Mësime mbi jetën dhe botën

"Unë mendoj që veprat e tij, duke u bazuar në 'Kështjella', lidhen me të kaluarën..."
(Nx22, Prishtinë)

Ky citim tregon një diferencim të qartë kohor në mendimin e nxënësve, ku ngjarjet historike dhe temat e veprës shihen si të ngulitura në një realitet të largët. Në të njëjtën kohë, ky tipar tregon vetëdije historike ku nxënësi arrin të identifikojë kontekstin historik të tekstit dhe të dallojë ndryshimet midis kohërave.

"Disa mesazhe morale vlejné edhe për ditën e sotme." (Nx26, Prishtinë)

Ky citim ilustron njohjen e kapërcimit të kontekstit historik nga ana e lexuesit, duke vlerësuar aftësinë e tekstit për të transmetuar ide që janë të rëndësishme pavarësisht kohës dhe vendit.

"Jo edhe aq shumë, por ndonjë mesazh ka vlerën e tij." (Nx12, Gjilan)

(Nx12, Gjilan) tregon një vlerësim selektiv, jo gjithçka është e aplikueshme sot, por disa mësim mbeten të vlefshme. Këtu dallojmë një qëndrim kritik ku nxënësi nuk pranon automatikisht të gjithë përmbajtjen si të vlefshme, por arrin të identifikojë elementët që mund të kenë relevancë aktuale.

"Disa prej tyre po, edhe sot besa është diçka e rëndësishme." (Nx21, Gjilan)

Ky citim tregon ndërgjegjësimin për vazhdimësinë kulturore të disa vlerave. Për nxënësin, besa nuk është vetëm koncept i së shkuarës, por normë morale që vazhdon të ketë rëndësi sociale sot.

"Unë menoj se dashuria lidhet me realitetin e sotëm sikur te Gjorgu edhe Diana." (Nx11, Viti)

Këtu shohim një aktualizim tematik të drejtpërdrejtë, ku nxënësi e vendos veprën në kontekstin e jetës së përditshme, duke treguar se temat si dashuria mbeten të përjetshme dhe relevante.

"Unë menoj se po, sepse të mësojnë diçka për botën, për jetën dhe gjëra të rëndësishme." (Nx13, Viti)

"Po sepse Kadare ka trajtuar plot tema të ndryshme si psh. dhimbja, gëzimi dhe këto kanë lidhje me realitetin e sotëm" (Nx 32, Prishtinë)

Në këto dy citime nxënësi nga Prishtina dhe Viti tregojnë një aftësi për të bërë gjeneralizime konceptuale, duke nxjerrë temat e mëdha njerëzore nga konteksti historik i veprës. Në këtë nivel, veprat e Kadaresë nuk lexohen vetëm si histori kombëtare, por si studime mbi natyrën njerëzore, me tema të përjetshme si vuajtja, dashuria, besa, morali dhe lufta.

Analiza tematike e përgjigjeve të nxënësve zbulon një gamë të gjerë perceptimesh mbi lidhjen e veprave të Kadaresë me realitetin e sotëm. Për disa, vepra është e lidhur ngushtë me të kaluarën historike dhe shërben si burim për njohjen e historisë kombëtare dhe formimin e identitetit kulturor. Për të tjerë, vlerat morale që përçohen si: besa, qëndresa, dashuria, dhimbja dhe gëzimi janë universale dhe të përjetshme, duke e bërë veprën të vlefshme për reflektim mbi jetën bashkëkohore.

Kjo shumëllojshmëri leximesh është një pasuri për mësimdhënësit, sepse ofron mundësi për diskutime të thella, debate mbi moralin dhe historinë, si dhe reflektim mbi jetën dhe vlerat. Për të përfituar prej saj, mësimdhënësia duhet të jetë dialogjike dhe e hapur, duke

respektuar dhe zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menduar kritikisht dhe për të ndërtuar kuptime të nuancuara dhe të personalizuar.

Tabela 12. Roli i mësimitdhënësit në përjetimin dhe kuptimin e veprave

Temat dhe kodet e dalura nga përgjigjet e nxënësve	
Roli i mësimitdhënësit në përjetimin dhe kuptimin e veprave	➤ Ndhmë për kuptim të thellë dhe emocional ➤ Shpjegime të qarta dhe të thjeshta ➤ Frymëzim dhe krijimi i pritshmërisë pozitive ➤ Pyetje dhe diskutim për të nxitur mendimin kritik ➤ Përjetim i pavarur në lexim

“Më inspiron, pra më jep kurajo që edhe unë të lexoj atë libër dhe e thjeshtëson më shumë.” (Nx24, Gjilan)

Sipas, Nx24, Gjilan evidentohet se mësuesi luan një rol të qartë didaktik, duke dekoduar gjuhën e Kadaresë, simbolikën ose kontekstin historik dhe duke e bërë atë më të aksesueshëm. Për nxënësit, kjo thjeshtësi nuk është reduktim i vlerës së tekstit, por një portë hyrëse që mundëson më shumë angazhim dhe përfshirje.

“Nuk ka shumë ndikim ngaqë lexoj si për qef.” (Nx10, Viti)

Ka nxënës që preferojnë autonominë në interpretim, duke përjetuar një lidhje më personale dhe të pavarur me tekstin. Ky është një aspekt i rëndësishëm për t'u njohur në planifikimin pedagogjik, jo të gjithë nxënësit kërkojnë ose kanë nevojë për të njëjtin nivel ndërmjetësimi. Disa shohin vlerë në eksplorimin individual, duke ndërtuar kuptime që pasqyrojnë përvojat, njohuritë dhe emocionet e tyre.

Unë mendoj që ndikon, një mësimitdhënësi i mirë mund të bëjë edhe një nxënës të pa interesuar të kuptoj dhe të adhuroj artin e letërsisë.” (Nx11, Viti)

Ky citim është veçanërisht i rëndësishëm sepse e njeh mësuesin si katalizator të shndërrimit të qëndrimeve, duke e kthyer një nxënës indiferent në një lexues të angazhuar.

“Ndikon shumë mirë sepse mësimitdhënësjë na bënë pyetje se çfarë personazhe, cili ishte mesazhi etj”. (Nx27, Viti)

Ky lloj ndërveprimi e kthen orën e letërsisë në një hapësirë dialogu, ku nxënësit nuk janë konsumatorë pasivë të interpretimit të mësuesit, por bashkëkrijues të kuptimit. Teoricienët e pedagogjisë, argumentojnë se bërja e pyetjeve dhe diskutimi i përbashkët nxisin mendimin kritik dhe zhvillojnë kompetenca demokratike, duke u dhënë nxënësve zë dhe hapësirë për të ndërtuar kuptime të tyre.

“Kryesisht para se mësuesja të na jap për të lexuar naj vepër na frymëzon duke na treguar për to pastaj na thotë që ti lexojmë” (Nx21, Gjilan).

Në bazë të përgjigjes së (Nx21, Gjilan), shihet se mësuesi nuk është thjesht dikush që ngarkon me detyra leximore, por frymëzues dhe nxitës i kureshtjes. Ai/ajo e paraqet tekstin si diçka interesante dhe të vlefshme, duke krijuar një klimë pritjeje pozitive dhe përfshirëse.

Analiza tematike e përgjigjeve të nxënësve mbi roli i mësimdhënësit në përjetimin dhe kuptimin e veprës letrare tregon një shumëllojshmëri funksionesh dhe përvojash. Për shumë nxënës, mësuesi është udhërrëfyes i domosdoshëm, që ndihmon në deshifrimin e tematikës, thjeshton gjuhën dhe kontekstin historik dhe nxit përjetim emocional dhe të thellë. Për këta nxënës, mësuesi është gjithashtu motivues, duke ndërtuar kureshtje dhe duke mbështetur ndërtimin e një qëndrimi pozitiv ndaj leximit. Në të njëjtën kohë, disa nxënës e shohin leximin si përvojë më të pavarur dhe personale, duke treguar se përjetimi i tyre është autonom dhe më pak i varur nga udhëzimi i drejtpërdrejtë.

Këto të dhëna sugjerojnë se praktika pedagogjike efektive duhet të jetë e diferencuar dhe fleksibile. Mësuesit duhet të dinë të balancojnë shpjegimin dhe ndërmjetësimin me hapësirën për përjetim personal dhe interpretim të lirë.

Ky rol kompleks kërkon aftësi komunikimi, ndjeshmëri ndaj nivelit të nxënësve dhe kreativitet në përdorimin e metodave të mësimdhënies, duke ndërtuar një mjedis të sigurt, dialogjik dhe motivues ku letërsia bëhet jo vetëm e kuptueshme, por edhe domethënëse dhe e dashur për të gjithë nxënësit

Tabela 13. Nevoja për më shumë analiza dhe diskutime për Kadarenë në klasë

Temat dhe kodet e dalura nga përgjigjet e nxënësve	
Nevoja për më shumë analiza dhe diskutime për Kadarenë në klasë	➤ Nevoja për më shumë analizë ➤ Rëndësia e udhëheqjes së mësuesit për të zbërthyer veprën ➤ Vlera edukative e mesazheve ➤ Perceptim i mjaftueshmërisë aktuale ➤ Vështirësi për shkak të tematikës së rëndë

“Unë mendoj se mësimdhënësi ynë përfshinë boll diskutime nga veprat e Ismail Kadaresë, por po duhen përfshirë” (Nx35, Viti).

Ky citim është interesant sepse sugjeron një perceptim të mjaftueshmërisë aktuale, por edhe një pranim të vlefshmërisë së diskutimeve të mëtejshme. Nxënësi nuk kërkon thjesht më shumë diskutim për vetë diskutimin, por e kupton vlerën e përfshirjes së vazhdueshme dhe të menduar mirë. Ky qëndrim pasqyron ndërgjegjësim kritik për balancimin e përmbajtjes së kurrikulës dhe për nevojën e planifikimit pedagogjik të kujdesshëm për të shmangur mbingarkesën ose përsëritjen e panevojshme.

“Ndoshta po, sepse veprat e Kadaresë janë shumë interesante dhe mësojmë shumë nga ato edhe pse nganjëherë janë shtirë mu kuptu”. (Nx28, Prishtinë).

Ky citim tregon vetëdijen e nxënësit për potencialin edukativ të veprës, por edhe dëshirën për të hulumtuar më thellë. Nxënësit njohin se Kadare nuk është autor për t'u lexuar sipërfaqësisht, por kërkon analizë të strukturuar dhe të udhëzuar për të zbërthyer temat, mesazhet dhe kompleksitetin stilistik. Nga perspektiva pedagogjike, kjo lidhet me nevojën për zhvillimin e shkathtësive të mendimit kritik dhe analitik, që është një nga qëllimet kryesore të edukimit letrar

“Po nganjëherë sepse librat që mësojmë janë shumë të mangët”. (Nx40, Prishtinë).

Kjo pasqyron sfidën që kanë mësimdhënësit në krijimin e një mjedisi mbështetës që i ndihmon të gjithë nxënësit të angazhohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nivelit të përgatitjes ose përvojës me letërsinë.

“Unë mendoj se po, për shkak se Ismail Kadare ka qenë një autor i shquar i letërsisë”. (Nx22, Gjilan).

Ky vlerësim tregon njohjen e autoritetit kulturor dhe letrar të Kadaresë. Nxënësit e perceptojnë si të vlefshme të diskutojnë dhe analizojnë veprat e tij jo vetëm për përmbajtjen e tyre, por edhe për kontributin në formimin e identitetit letrar dhe kulturor shqiptarë.

Analiza tematike e përgjigjeve nxjerr në pah një konsensus të gjerë mbi nevojën për analiza dhe diskutime më të thella dhe të strukturuar mbi veprat e Ismail Kadaresë në klasë. Nxënësit nuk e shohin letërsinë e Kadaresë si thjesht një lexim narrativ apo historik, por si burim të pasur për reflektim moral, kulturor dhe estetik. Megjithatë, perceptimet ndryshojnë në ton dhe intensitet: disa nxënës kërkojnë më shumë diskutime për të zbërthyer kompleksitetin e veprës, të tjerë pranojnë se diskutimet aktuale janë të mjaftueshme, ndërsa disa vërejnë vështirësi për shkak të tematikës së rëndë dhe kufizimeve të materialeve mësimore.

Këto dallime sugjerojnë se planifikimi pedagogjik duhet të jetë fleksibël dhe i ndjeshëm ndaj niveleve të ndryshme të nxënësve. Mësuesit duhet të krijojnë hapësira dialogjike që inkurajojnë interpretimin personal dhe të udhëhequr, duke mbështetur shpjegimin e qartë të temave të ndërlikuara dhe sfidimin e ideve të thjeshta.

Në këtë mënyrë, mësimi i veprës së Kadaresë mund të shndërrohet në një proces formimi kulturor dhe kritik, që përgatit nxënësit jo vetëm të kuptojnë një autor të madh shqiptar, por edhe të reflektojnë në mënyrë të pavarur dhe të informuar mbi historinë, moralin dhe jetën bashkëkohore

Tabela 14. Dëshira për të lexuar më shumë nga Kadare ose autorë të ngjashëm

Temat dhe kodet e dala nga përgjigjet e nxënësve	
Dëshira për të lexuar më shumë nga Kadare ose autorë të ngjashëm	➤ Interes për historinë kombëtare ➤ Mesazhe morale dhe edukative ➤ Zhvillim personal dhe intelektual ➤ Ndjeshmëri gjuhësore dhe dialektore ➤ Mospërputhje me interesat personale

“Mua më pëlqen Kadare kam lexuar Kronikë në gur dhe Kështjellën janë shumë të mira, por unë e gjej interesin tek librat e huaj (aglezë) që kanë të bëjnë me psikologjinë dhe mendjen”(Nx11, Viti).

Ky citim është i vlefshëm sepse nuk shpreh refuzim ndaj Kadaresë, por tregon pluralizëm në interesat letrare. Ai pasqyron një qasje moderne ndaj leximit, ku nxënësit nuk ndihen të kufizuar vetëm nga letërsia kombëtare, por kërkojnë larmi tematike dhe zhanrore që pasqyrojnë interesat dhe nevojat e tyre personale për zhvillim.

“Po sepse mendja e tij dhe ngjarjet e tij janë një nivel i lartë letërsie dhe prandaj dua të lexoj më shumë në veprat e tij” (Nx31, Prishtinë).

Këtu vërehet vlerësimi për kompleksitetin dhe cilësinë artistike të veprës. Nxënësi e kupton leximin e Kadaresë si sfidë dhe ushtrim intelektual, një mënyrë për të zhvilluar analizën, imagjinatën dhe shijen estetike.

“Po, por jo libra në dialektin gegë” (Nx2, Prishtinë).

Kjo përgjigje nga (Nx2, Prishtinë), sugjeron vështirësi ose preferenca gjuhësore, duke treguar se qasja në letërsinë shqipe nuk është gjithmonë homogjene. Ai tregon nevojën për ndjeshmëri pedagogjike në përzgjedhjen e teksteve dhe për diskutime mbi pasurinë e dialekteve dhe standardit gjuhësor në kuadër të edukimit kulturor.

“Po sepse autorët shqiptarë kanë rrëfime të shumta dhe shumë të mira psh me kohën e luftës, përjetimet e tyre e të gjitha këto që janë të shprehura në libra më bëjnë të ndihem shumë mirë dhe të mësoj gjëra të reja” (Nx5, Gjilan).

Ky citim tregon identifikimin emocional dhe interesin epistemologjik: leximi i Kadaresë dhe autorëve shqiptarë nuk është vetëm zbavitës, por edhe mjet për të njohur dhe kuptuar historinë e shqiptarëve.

Analiza tematike e përgjigjeve të nxënësve mbi dëshirën për të lexuar më shumë Kadare ose autorë të ngjashëm zbulon një gamë të pasur motivimesh dhe reflektimesh. Shumica e nxënësve tregojnë interes të sinqertë dhe entuziazëm, duke theksuar vlerën historike, morale dhe edukative të veprave. Ata e shohin Kadarenë si autor që i sfidon, i frymëzon dhe i ndihmon të kuptojnë më mirë veten dhe shoqërinë.

Megjithatë, shfaqen edhe zëra kritikë dhe të ndryshëm, që preferojnë tema dhe autorë të tjerë, që kërkojnë larmi gjuhësore dhe tematike, ose që duan të eksplorojnë fusha të tjera si psikologjia dhe mendja. Kjo shumëllojshmëri është një pasuri për procesin mësimor, duke i ftuar mësuesit të ndërtojnë kurikula të balancuara, që

respektojnë trashëgiminë kombëtare, por që gjithashtu mbështesin shijet dhe nevojat individuale të nxënësve.

Në këtë kuptim, leximi i Kadaresë nuk duhet të shihet si qëllim në vetvete, por si portë për të zhvilluar dashurinë për leximin, mendimin kritik dhe ndjenjën e identitetit kulturor, duke krijuar lexues të pjekur, të hapur dhe të ndërgjegjshëm për vlerat e ndryshme që letërsia mund të ofrojë.

6.2 Rezultatet e nxjerra nga pyetësorët e zhvilluar me nxënës

Rezultatet e hollësishme tregojnë se 46.9% e nxënësve kanë shprehur pëlqim të përgjithshëm për leximin duke u përgjigjur “Po” në pyetjen “A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?”. Ky tregues është relativisht i mirë, duke sugjeruar një bazë të shëndoshë interesi për letërsinë në mesin e të rinjve. Për më tepër, kur u pyetën në mënyrë specifike për veprat e Ismail Kadaresë, një pjesë e madhe e nxënësve i kanë vlerësuar ato si mjaft ose shumë interesante, me 55% të të anketuarve që dhanë nota 4 dhe 5 në një shkallë vlerësimi nga 1 deri në 5 për nivelin e interesit. Ky rezultat tregon se shkrimtaria e Kadaresë ka një efekt tërheqës dhe ngacmues për imagjinatën dhe mendimin e nxënësve. Gjithashtu, sa i përket kuptueshmërisë së mesazhit dhe temave të trajtuara në këto vepra, 75.4% e nxënësve i kanë vlerësuar ato si mesatarisht, mjaft ose shumë të kuptueshme. Ky është një tregues pozitiv që dëshmon se veprat e Kadaresë janë të arritshme për lexues të rinj dhe arrijnë të përcjellin në mënyrë të qartë temat e tyre të rëndësishme, si historia kombëtare, identiteti, lufta dhe raporti i individit me pushtetin. Megjithatë, analiza e thelluar e të dhënave nxori në pah një dallim të qartë në nivelin e interesit për lexim dhe perceptimin e veprave mes nxënësve të shkollave të ndryshme. Ky fakt sugjeron se, përveç qëndrimit pozitiv të përgjithshëm ndaj veprave të Kadaresë, ndikojnë edhe faktorë të tjerë të rëndësishëm si ambienti shkollor, cilësia dhe mënyra e mësimdhënies së lëndës së letërsisë, përkushtimi i mësimdhënësve dhe mbështetja që u jepet nxënësve për të zhvilluar shprehitë e leximit kritik dhe analitik. Po ashtu, faktorë të tjerë si qasja ndaj librave, kultura e leximit në familje dhe mjetet didaktike të përdorura mund të ndikojnë ndjeshëm në përjetimin dhe interpretimin e veprave letrare. Pra, mund të thuhet se hipoteza fillestare është e pranueshme dhe mbështetet

në tërësi nga të dhënat e mbledhura, pasi një pjesë e madhe e nxënësve shfaqin një perceptim pozitiv, interes dhe kuptueshmëri të mirë për veprat e Ismail Kadaresë.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se ky perceptim nuk është i njëtrajtshëm në të gjitha shkollat e përfshira në studim. Këto dallime nënvizojnë nevojën për ndërhyrje të synuara në politikën arsimore dhe në praktikat pedagogjike, në mënyrë që të sigurohet qasje më e barabartë dhe mbështetje më efektive për zhvillimin e kulturës së leximit dhe aftësive të interpretimit kritik të nxënësve në të gjitha nivelet dhe mjediset arsimore.

KAPITULLI VII

KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

7.1. Konkluzionet

Ky studim synoi të analizojë perceptimin e nxënësve të klasave VIII dhe IX ndaj veprave letrare të Ismail Kadaresë, duke u fokusuar në interesin, kuptueshmërinë dhe ndikimin emocional që këto vepra kanë tek ta. Nëpërmjet pyetësorëve dhe analizës së përgjigjeve të tyre, u arrit të identifikohen disa tendenca të qarta dhe të rëndësishme mbi mënyrën si nxënësit e përjetojnë dhe i vlerësojnë këto vepra.

- Shumica e nxënësve të klasave VIII dhe IX kanë një perceptim pozitiv ndaj veprave letrare të Ismail Kadaresë dhe i konsiderojnë ato të rëndësishme për kuptimin e kulturës dhe historisë shqiptare.
- Rreth 47% e nxënësve deklarojnë se u pëlqen të lexojnë në përgjithësi, ndërsa mbi 54% i kanë vlerësuar veprat e Kadaresë si mjaft ose shumë interesante.
- Rreth 75% e nxënësve e kanë perceptuar përmbajtjen e veprave si të kuptueshme (mesatarisht, mjaft ose shumë të kuptueshme), duke treguar se temat dhe gjuha janë të përshtatshme për nivelin e tyre.
- Veprat më të lexuara janë “Kështjella” dhe “Prilli i thyer”, ndoshta për shkak të përfshirjes në planprogramin shkollor dhe temave që ngjallin interes tek nxënësit.
- Nxënësit shfaqin emocione pozitive gjatë leximit, si ndjenja krenarie, ndërlihdje me identitetin kombëtar dhe aftësi për të reflektuar mbi temat morale dhe historike.
- Perceptimi nuk është i njëtrajtshëm në të gjitha shkollat dhe ndikohet nga faktorë si mjedisi shkollor, mënyra e mësimdhënies dhe përkrahja e mësuesve.

Rezultatet e këtij studimi dëshmojnë se veprat e Ismail Kadaresë kanë një ndikim të rëndësishëm edukativ dhe kulturor tek nxënësit, duke nxitur interes, krenari kombëtare dhe mendim kritik. Megjithatë, për të rritur këtë ndikim, kërkohet angazhim më i madh i mësimeve dhe përdorimi i metodave kreative për të lehtësuar kuptimin dhe përjetimin e veprave letrare. Këto gjetje theksojnë rëndësinë e ruajtjes dhe promovimit të letërsisë kombëtare në arsimimin e brezave të rinj.

7.2. Rekomandimet

Për të rritur interesin e nxënësve për letërsinë dhe për t'i ndihmuar ata ta kuptojnë më thellë veprën e Ismail Kadaresë, është e domosdoshme që mësimdhënësit të përdorin qasje më të përshtatshme dhe të afërta me përjetimet e nxënësve. Të dhënat e mbledhura gjatë këtij studimi tregojnë se nxënësit e klasave VIII dhe IX, ndonëse e vlerësojnë rëndësinë e letërsisë dhe veprave të Kadaresë për kulturën kombëtare, shpesh e perceptojnë procesin e mësimdhënies si monoton dhe të largët nga përjetimet e tyre personale. Për këtë arsye, rekomandimet e mëposhtme synojnë të ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies së letërsisë dhe në rritjen e interesit të nxënësve për leximin dhe analizën e veprave letrare.

- Mësimdhënësit duhet të përdorin metoda më të larmishme dhe kreative në analizën e veprave të Kadaresë, për ta bërë leximin më tërheqës dhe kuptues për të gjithë nxënësit.
- Të zhvillohen aktivitete interaktive (si debate, dramatizime, ese kreative) që ndihmojnë nxënësit të shprehin emocionet dhe mendimet mbi temat e lexuara.
- Të organizohen takime me shkrimtarë, kritikë letrarë apo lexime publike për të nxitur kulturën e leximit dhe për të krijuar lidhje më të forta me letërsinë kombëtare.
- Të trajnohen mësuesit mbi teknikat e udhëheqjes së analizës letrare që përfshijnë të gjithë nxënësit dhe që synojnë zhvillimin e mendimit kritik dhe empatik.
- Të bëhen studime të mëtejshme për të kuptuar faktorët që ndikojnë te nxënësit që shfaqin më pak interes ose që hasin vështirësi, me qëllim që të ndërtohen strategji më të personalizuar.

REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

- Abdalrahman, K. K. (2021). Teaching and Learning Writing Skills through Literature. *Canadian Journal of Language and Literature Studies*, 1-10.
doi:<https://doi.org/10.53103/cjlls.v1i2.11>
- ASHAK. (2023). *Biografi*. Retrieved from Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK): <https://ashak.org/anetaret/ismail-kadare/>
- Avdyli, M. (2019). Mythical Symbols in the Poetry of Ismail Kadar. *ResearchGate*, 164-167.
doi:10.13189/lis.2019.070406
- Bellos, D. (2021, November 21). *Why Should We Read Ismail Kadare?* Retrieved from World Literature Today: <https://worldliteraturetoday.org/2021/winter/why-should-we-read-ismail-kadare-david-bellos>
- Bhandari, P. (2024). Ethical Considerations in Research | Types & Examples. *Scribbr*. Retrieved from <https://www.scribbr.com/methodology/research-ethics/>
- Burns, M., Bally, J., Burles, M., Holtslander, L., & Peacock, S. (2022). Constructivist Grounded Theory or Interpretive Phenomenology? Methodological Choices Within Specific Study Contexts. *Sage Journals*. doi:<https://doi.org/10.1177/16094069221077758>
- Celiku, L. A. (2016). Kadare's lexicon opposite the lexicon of the Albanian language. *ResearchGate*, 10-15. doi:DOI:10.24289/ijsser.283582
- Champseix, J.-P. (2024, Juillet 5). *Une plume contre des bunkers*. Retrieved from EaN: <https://www.en-attendant-nadeau.fr/2024/07/05/une-plume-contre-des-bunkers-ismail-kadare/>
- Çitaku, S. K., & Abdyli, F. M. (2024). Literature in Primary Schools in Kosovo, its Artistic and Educational Character. *Eurasian Journal of Educational Research*, 1-16. Retrieved from <https://ejer.com.tr/manuscript/index.php/journal/article/view/1678>
- Gabrielsen, I., Blikstad-Balas, M., & Tengberg, M. (2019). The role of literature in the classroom: How and for what purposes do teachers in lower secondary school use literary texts? *ResearchGate*, 1-31. doi:10.17239/L1ESLL-2019.19.01.13
- George, T. (2023, June 22). *Semi-Structured Interview | Definition, Guide & Examples*. Retrieved from Scribbr: <https://www.scribbr.com/methodology/semi-structured-interview/>
- Haxhijaha, E. (2015). Të lexuarit e kuptimshëm dhe kritik te nxënësit e klasave të gjashta. *ResearchGate*, 12. Retrieved from https://www.researchgate.net/publication/296060794_Te_lexuarit_e_kuptimshem_dh_e_kritik_te_nxenesit_e_klasave_te_gjashta

- Ibishi, A., & Tahiri, L. (2022). Comparative analysis of thought styles: children's narrators in *The Curious Incident of the Dog in the Night-Time* by Mark Haddon and in *Chronicle and Stone* by Ismail Kadare. *Primerjalna književnost*, 145-165.
doi:<https://doi.org/10.3986/pkn.v45.i2.09>
- Jones, S. (2022, February). *Interpreting Themes From Qualitative Data: Thematic Analysis*. Retrieved from EVAL ACADEMY: <https://www.evalacademy.com/articles/interpreting-themes-from-qualitative-data-thematic-analysis>
- Kadare, I. (1980). *Kështjella*. Prishtinë: Rilindja.
- Kadare, I. (1980). *Kronikë në gur*. Prishtinë: Rilindja.
- Kadare, I. (2003). *Prilli i thyer*. Tiranë: Onufri.
- Kadare, I. (2007). *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*. Tiranë: Onufri.
- Kanodia, K. (2025, April 16). *7 Tips for Building Critical Thinking Through Literature*. Retrieved from Literature Experts: <https://literatureexperts.com/qa/7-tips-for-building-critical-thinking-through-literature/>
- Kanodia, K., & Cornici, A. (2023, December 19). *The Role of Literature in Promoting Empathy and Understanding*. Retrieved from Literature Experts: <https://literatureexperts.com/insight/the-role-of-literature-in-promoting-empathy-and-understanding/>
- Karunaratne, S. K., & Navaratne, H. (2023). The Impact of the Reading Habit on the Writing Skills of Primary Students. *ResearchGate*, 1-15. doi:10.22158/sll.v7n4p15
- Kobayashi, H. (2022). Ismail Kadare's literary strategies. *CEJSH*, 220-234. Gjetur në file:///C:/Users/HP/Downloads/articles-58434346.pdf.pdf
- Köller, O., & Retelsdorf, J. (2014). Reciprocal effects between reading comprehension and spelling. *ResearchGate*, 77-83. doi:10.1016/j.lindif.2013.11.007
- Lamçja, D. (2022). Analysis of Ismail Kadare Prose Prospects Under the Optics of V. L. Propp. *ResearchGate*, 75-93. Retrieved from https://www.researchgate.net/publication/361036616_Analysis_of_Ismail_Kadare_Prose_Prospects_Under_the_Optics_of_V_L_Propp
- Mandalà, M. (2012). Prefazione al romanzo "Kështjella". *ACADEMIA.edu*, 6-7. Retrieved from https://www.academia.edu/123870467/Parath%C3%ABnie_a_Ismail_Kadare_K%C3%ABshtjella
- Matthews, B., & Ross, L. (2010). *Research Methods: A Practical Guide For The Social Sciences*. England: Pearson Education Limited.
- Mirza, H., Bellalem, F., & Mirza, C. (2023). *Ethical Considerations in Qualitative Research: Summary Guidelines for Novice Social Science Researchers*. Retrieved from Research

- Gate:
https://www.researchgate.net/publication/370838199_Ethical_Considerations_in_Qualitative_Research_Summary_Guidelines_for_Novice_Social_Science_Researchers
- Naeem, M., Howell, W. O., & Ranfagni, S. (2023). A Step-by-Step Process of Thematic Analysis to Develop a Conceptual Model in Qualitative Research. *Sage Journals*.
doi:<https://doi.org/10.1177/16094069231205789>
- PALI, B., & MACKAY, R. E. (2021). Blood feud through the historical imagination of Ismail Kadare: An. *OÑATI SOCIO-LEGAL SERIES*, 1-23.
- Pali, B., & Mackay, R. E. (2021). Blood feud through the historical imagination of Ismail Kadare: An analysis of Broken April. *ResearchGate*, 2-22. doi:10.35295/osls.iisl/0000-0000-0000-1215
- Peci, M. (2019). NARRATIVE STYLES IN THE NOVEL "CHRONICLE IN STONE" OF ISMAIL KADARE. *CYBERLENINKA*, 11. Retrieved from <https://cyberleninka.ru/article/n/narrative-styles-in-the-novel-chronicle-in-stone-of-ismail-kadare>
- Petrat, P. (2022, June 29). *What Is a Questionnaire and How Is It Used in Research?* Retrieved from CINT: <https://www.cint.com/blog/what-is-a-questionnaire-and-how-is-it-used-in-research/>
- Phillips, H. N. (2023). Developing critical thinking in classrooms: Teacher. *Reading & Writing - Journal of the Literacy Association of South Africa*, 2-9. Retrieved from <https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1382960.pdf>
- Razaq, R., Nijabat, A., & Ashfaq, N. (2019). Role of Literary Texts in Improving Writing Skills. *Journal of Communication and Cultural Trends (JCCT)* , 55-72.
doi:<https://doi.org/10.32350/jcct.12.05>
- Ruffles, T. (2019, October 31). *Chronicle in Stone, by Ismail Kadare*. Retrieved from WordPress: <https://tomruffles.wordpress.com/2019/10/31/chronicle-in-stone-by-ismail-kadare/>
- Rugovaj, J. (2019). GJENERALI I USHTRISE SE VDEKUR" KOMENT DHE ANALIZE. *ACADEMIA.edu*, 4-5. Retrieved from https://www.academia.edu/38118524/_GJENERALI_I_USHTRISE_SE_VDEKUR_KOMENT_DHE_ANALIZE_ISMAIL_KADARE
- Shaheen, M., Pradhan, S., & Ranajee, R. (2019). Sampling in Qualitative Research. *researchgate*. doi:10.4018/978-1-5225-5366-3.ch002
- Soares, L. F. (2016). ENTRE OS CERCOS: A 'ILÍADA' E A FICÇÃO DE ISMAIL KADARÉ | BETWEEN THE SIEGES: THE 'ILIAD' AND THE FICTION OF ISMAIL KADARE. *ResearchGate*, 65-77.
doi:10.9771/2176-4794ell.v0i55.17142

- Soy, S., Maisarah, I., & Ly, S. (2023). Students' Perceptions of Literary Texts, Challenges in Learning, and Learning Strategies. *ResearchGate*, 81-94. doi:10.21043/jetli.v6i2.19925
- Stan, R. V. (2015). The Importance of Literature in Primary School Pupils' Development and Personal Growth. *ResearchGate*, 454-459. doi:10.1016/j.sbspro.2015.02.144
- Suta, B. (2021). Dante nella memoria creativa del romanzo Prilli i. *Open Edition Books*, 1-17. Retrieved from file:///C:/Users/HP/Downloads/ledizioni-14493.pdf
- Suwadi, S. (2021). The Value of Education in Literature and Relevance for Teaching . *EDUTEC: Journal of Education And Technology*, 1-9.
- Terziu, F. (2019). WRITING THE DICTATORSHIP: REUSE OF MYTH IN ISMAIL KADARE'S. *LSBU*, 1-230.
- Vilaça, G. V. (2024). Broken April: Narratology, Legal Normativity, and the Experience of Law. *SSRN*, 1-43. Retrieved from https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=5024049
- Williamson, K. (2018). Chapter 16 - Questionnaires, individual interviews and focus group interviews. *ScienceDirect*. doi:<https://doi.org/10.1016/B978-0-08-102220-7.00016-9>

SHTOJCA

ANKETA ME NXËNËS

Të nderuar nxënës,

Fillimisht ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë pyetësor. Hulumtimi ka për qëllim të kuptojë perceptimet dhe përvojat tuaja gjatë leximit të veprave të autorit Ismail Kadare, si pjesë e planprogramit mësimor të letërsisë.

Ju siguroj se të gjitha përgjigjet janë plotësisht anonime dhe konfidenciale. Të dhënat e mbledhura do të përdoren vetëm për qëllime akademike dhe kërkimore, dhe nuk do të ndërlihen në asnjë mënyrë me emrin apo identitetin tuaj.

1. Gjinia:
 - ☐ Mashkull
 - ☐ Femër
2. Shkolla në të cilën ndjekë mësimet:
 - ☐ SHFMU “Naim Frashëri”, Prishtinë
 - ☐ SHFMU “Selami Hallaçi”, Gjilan
 - ☐ SHFMU “Bafti Haxhiu”, Viti
3. Klasa që ndjek:
 - ☐ Klasa 8
 - ☐ Klasa 9
4. A të pëlqen të lexosh në përgjithësi?
 - ☐ Po
 - ☐ Jo
 - ☐ Nganjëherë
5. Cilin nga titujt e mëposhtëm e ke lexuar? (Mund të shënosh më shumë se një)
 - ☐ Prilli i thyer
 - ☐ Gjenerali i ushtrisë së vdekur
 - ☐ Kronikë në gur
 - ☐ Kështjella
 - ☐ Asnjë prej tyre
6. Sa interesant/e e ke gjetur veprën (veprat) që ke lexuar?
(Vlerëso në një shkallë nga 1 në 5, ku 1 = fare jo interesante dhe 5 = shumë interesante)
 - ☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5

7. Sa të kuptueshme ishin temat dhe mesazhet e veprës/veprave të Kadaresë?

- ☐ Shumë të kuptueshme
- ☐ Mjaft të kuptueshme
- ☐ Mesatarisht të kuptueshme
- ☐ Të vështira për t'u kuptuar
- ☐ Shumë të vështira

8. Si e përjetove leximin e veprës/veprave të Ismail Kadaresë? (Përshkruaj ndjenjat apo mendimet që pate)

9. Cila temë ose personazh të ka lënë më shumë përshtypje dhe pse?

10. A mendon se veprat e Kadaresë kanë lidhje me realitetin e sotëm?

11. Si ndikon mënyra e mësimdhënies së mësuesit në mënyrën se si ti e përjeton dhe kupton letërsinë?

12. A mendoni se mësimdhënësit duhet të përfshijnë më shumë diskutime dhe analiza të veprave të Ismail Kadaresë në mësimet e letërsisë?

13. A do të dëshiroje të lexoje më shumë nga Kadare ose nga autorë të ngjashëm shqiptarë? Pse?

Ju faleminderit shumë!

Hatixhe Gashi